



RAPORTI VJETOR 2013



PËRMBAJTJA

FAQE 2
VIZIONI, MISIONI, VLERAT



FAQE 6
GRUPI ÇALIK



FAQE 8
MOMENTE TË RËNDËSISHME



FAQE 14
MESAZHI I KRYETARIT



FAQE 16
MESAZHI I DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM



FAQE 18
ÇMIMET DHE VLERËSIMET NË VITIN 2013



FAQE 23
VLERËSIM I AKTIVITETEVE TË VITIT 2013



FAQE 37
OBJEKTIVAT PËR VITIN 2014



- 2 Vizioni, Misioni, Vlerat
- 4 BKT nëpërmjet Shifrave
- 6 Grupi Çalik
- 8 Momente të Rëndësishme
- 10 Bordi Drejtues
- 12 Menaxhimi i Lartë
- 14 Mesazhi i Kryetarit
- 16 Mesazhi i Drejtorit të Përgjithshëm
- 18 Çmimet dhe Vlerësimet në Vitin 2013
- 20 Dega Kosovë
- 21 BKT Kosova nëpërmjet Shifrave
- 23 Vlerësim i Aktiviteteve në vitin 2013
 - 23 Bankingu Individual
 - 27 Bankingu Tregtar dhe i Korporatave
 - 31 Thesari dhe Institucionet Financiare
 - 31 Grupi i Menaxhimit të Riskut
 - 33 Burimet Njerëzore
 - 35 Përgjegjësia Sociale e Korporatës: Qasjet dhe Praktikat
- 37 Objektivat për vitin 2014
- 38 Raporti i Auditorëve të Pavarur dhe Pasqyrat Financiare të Konsoliduara



Duke vlerësuar vlerat historike dhe kulturore të vendit të saj, BKT ndërmori restaurimin e ndërtesës së Degës Korçë, një godinë e ndërtuar fillimisht në vitet 30. Puna për këtë projekt përfundoi në vitin 2013.

VIZIONI YNË ËSHTË PASURIMI I EKSPERIENCËS NGA NJËRA DITË NË TJETRËN ...



Historiku i Bankës Kombëtare Tregtare (BKT) fillon në vitin 1925, kohë kur u inaugurua selia e saj në Durrës. Banka mori formën që ka aktualisht në vitin 1993 pas bashkimit të Bankës Tregtare Shqiptare dhe Bankës Kombëtare të Shqipërisë. BKT u rregjistrua si shoqëri aksionere në vitin 1997.

Pas privatizimit të saj në vitin 2000, BKT u fut në një periudhë rritje dhe zhvillimi të fuqishëm. Në vitin 2006 Banka u ble nga Çalik Group, një konglomerat turk. Me strukturën e kapitalit të saj të përforcuar shumë, me avantazhet konkurruese dhe me zgjerimin e dinamikës së saj, BKT filloi një fazë të re zgjerimi të suksesshëm dhe të qëndrueshëm.

Duke qenë banka më e vjetër dhe ofruesi i parë i shërbimeve financiare në vend, BKT ka eksperiencë me rrënjë të thella, njohuri të thelluar lokale, si dhe një qasje shumë novatore të mbështetur nga vizioni i saj. BKT është banka e vetme e cila është vlerësuar në mënyrë të vazhdueshme me vlerësimet më të larta të mundshme në Shqipëri.

Duke operuar nëpërmjet një rrjeti prej 84 degësh (60 në Shqipëri dhe 24 në Kosovë), BKT është e pranishme gjerësisht në vend, duke qenë banka më e madhe shqiptare në rajon.

VIZIONI, MISIONI, VLERAT

VIZIONI 2015

“Do të rritemi mesatarisht me 20% dhe do të kemi 25% kthim të kapitalit tonë aksioner. Kjo do ta çojë praninë tonë në treg në nivelin 25% në të gjitha segmentet; aktivet totale do të shkojnë në 4 miliardë dollarë amerikanë dhe kapitali aksioner në 325 milionë dollarë amerikanë. Do të marrim të paktën një licencë tjetër bankare në rajon dhe do të jemi banka numër një në Shqipëri.”

MISIONI

“Misioni i BKT-së është t’u sigurojë njerëzve qetësi, lehtësi dhe mundësi në sektorin bankar.”

VIZIONI

E dimë se çfarë kërkoni dhe bëjmë çmos që ju ta keni. Kjo thjesht na bën bankën e parë dhe më të mirën.

PARIMET E PUNËS

Punë në grup
Përgjegjësi
Cilësi
Efikasitet
Komunikim i hapur
Vëmendje tek klienti

VLERAT

Ndershmëri
Drejtësi
Njerëzit të parët
Konfidencialitet
Transparencë
Përgjegjshmëri

BANKOMAT
24

BKT

HUSA TRIJANA PALAS

MILIKI TRUJANA
MILIKI PERUSAHAAN
KREDIT DAN LAIN-LAIN

BANKOMAT

MoneyGram
transferansi parash

MoneyGram
transferansi parash

BKT NËPËRMJET SHIFRAVE

TREGUESIT FINANCIARË

Treguesit kryesorë (në milionë dollarë amerikanë)	2011	2012	2013	Ndryshimi % (2012-2013)
Totali i aktivitet	1,865	2,337	2,676	14.5
Hua për klientët	778	854	886	3.7
Depozitat e klientëve	1,581	1,885	2,154	14.3
Kapitali aksioner	138	184	215	16.6
Fitimi neto	19	31	39	25.8








RAPORTET KYÇE

Treguesit e performancës (%)	2011	2012	2013
Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit	12.93	14.30	14.56
Kthimi mbi aktivet mesatare	1.11	2.19	1.25
Kthimi mbi kapitalin neto	16.43	33.39	16.64

STRUKTURA AKSIONERE

Çalik Finansal Hizmetler, degë e Çalik Holding e Turqisë, u bë pronari i vetëm dhe i plotë i BKT-së në vitin 2009.

Struktura aksionere deri më 31 dhjetor 2013	Numri i aksioneve	Totali në dollarë amerikanë	%
Çalik Finansal Hizmetler A.Ş.	11,252,300	138,965,905	100

TOTALI I AKTIVIT
(USD MILIONË)HUATË
(USD MILIONË)TOTALI I DEPOZITAVE
(USD MILIONË)KAPITALI AKSIONER
(USD MILIONË)FITIMI NETO
(USD MILIONË)RAPORTI I MJAFTUESHMËRISË
SË KAPITALIT (%)KTHIMI MBI AKTIVET MESATARE
(%)KTHIMI MBI KAPITALIN
(%)

GRUPI ÇALIK

Grupi Çalik rritet nëpërmjet shqisës së tij për biznes novativ

I krijuar me iniciativën e Ahmet Çalik, pjesëtar i familjes Çalik që merrej me tregti që prej vitit 1930, Çalik Holding është aktualisht i pranishëm në sektorët e energjisë, telekomunikacionit, tekstileve, ndërtimit, financës dhe minierave.

Si një ndër kompanitë më të mëdha industriale në Turqi, Çalik Holding punëson mbi 20 mijë punonjës dhe është e pranishme në 17 shtete të ndryshme të botës. Grupi bën biznes në Azinë Qëndrore, Ballkan, Lindjen e Mesme dhe në Afrikë si një ndër investitorët kryesor turq me aktive të konsoliduara që pothuajse kapin shifrën e 7.5 miliardë dollarësh amerikanë.

Duke arritur rritje të qëndrueshme si në Turqi dhe në shtete të tjera në të cilat është i pranishëm që prej ditës së themelimit, Grupi bleu ALBtelecom, operatorin e telefonisë fikse dhe furnizuesin e internetit të Shqipërisë në vitin 2007, Yeşilirmak Electricity Distribution Inc. (YEDAŞ), e cila është kompania përgjegjëse për furnizimin me energji elektrike të pesë provincave të Turqisë në vitin 2010, Ndërmarrjen e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike të Kosovës në vitin 2012, dhe ARAS EDAS, një kompani aktive në 7 provinca të Turqisë në vitin 2013.

Çalik Holding Energy Group u bë njëra ndër kompanitë më të preferuara në vende me rezerva të pasura energjitike, të tilla si Azia Qëndrore, Lindja e Mesme dhe Afrika, dhe e ruajti portofolin e saj të biznesit në vitin 2013 falë besueshmërisë në sektorin global të energjisë dhe mentalitetit të biznesit që e dallon Grupin nga konkurrentët e tij. Çalik Enerji e ka

pozicionuar veten si kontraktuesin më të madh të EPC-së në Gjeorgji me projektin Gardabani në vitin 2013, ndërsa përfundoi dy impiante për prodhim energjie me kapacitet të përgjithshëm prej 2000-MW në Irak gjatë të njëjtit vit. Kompania vijoi ndërtimin e tre impianteve të filluara në Ahal Lebab, në Turkmenistan, në provincat e Mari-t në vitin 2013 dhe nënshkroi një kontratë për dy impiante të tjera në Ahal dhe Derweze. Po ashtu, gjatë vitit 2013 u përfundua dhe Projekti Adacami HEPP në Rize.

Gap Insaat ka nënshkruar një kontratë me EPC-në për Portin Ndërkombëtar Detar të Türkmenbaşı, i cili është projektuar si një portë logjistike për rrugën nga Azia në Europë, duke përfshirë gjashtë porte anijesh dhe një port për riparimin e anijeve, me vlerë projekti në 1.5 miliardë dollarë amerikanë. Çalik Gayrimenkul, kompani ndërtimesh dhe rinovimi urban



E njohur për prestigjin, besueshmërinë dhe strukturën e fortë financiare të demonstruar nga aktivitetet e vazhdueshme në pjesë të ndryshme gjeografike në botë, Çalik Holding bashkëpunon me shumë kompani globale dhe të fuqishme në nivelin ndërkombëtar.

e Grupit Çalik mori çmimin e parë për "Tarlabaflı" 360', në kategorinë e "Rinovimit Urban" në "Çmimet Europiane për Pronat të vitit 2013", organizata më prestigjioze për dhënien e çmimeve për pronat e patundshme në Europë.

Duke e bërë punën në përputhje me strategjitë e zhvillimit të formësuar nga suksesi i treguar, Lidya Madencilik, kompani e Çalik Holding e pranishme në sektorin e minierave, i ka rritur aksionet e saj nga 50% deri në 80% në kapitalin e saj të përbashkët me Alacer Gold, Polimetal Madencilik. Gjatë të njëjtit vit, prodhimi i arit në Minierën Çöpler, e zotëruar nga Anagold, degë e Lidya Madencilik, e ka tejkaluar sasinë e 270,000 oncëve, duke shënuar kështu një rritje prej 43% nga një vit më parë.

Duke i realizuar projektet e saj me një qasje novatore dhe të qëndrueshme, Aktif Bank në vitin 2013 krijoi Aktif Bank Sukuk Varlik Kiralama A.S. me qëllimin e lëshimit të certifikatave leasing. Aktif Bank i ka kaluar gjigandët botërorë dhe mori çmimin e parë për projektin "Aktif Nokta" në kategorinë e "Kanaleve për Shpërndarjen Fizike" ("Physical Distribution Channels") gjatë një aktiviteti të organizuar nga Shoqata Europiane e Menaxhimit dhe e Marketimit (EFMA).

BKT, kompani e Grupit Çalik që operon në Shqipëri dhe në Kosovë, është shpallur për herë të tretë gjatë katër viteve të fundit si "Banka më e Mirë" nga The Banker, një ndër revistat më prestigjioze për tregjet ndërkombëtare financiare.

Nga ana tjetër, Grupi e shiti Turkuvas Media Group si pjesë të strategjisë së tij për t'u përqëndruar më shumë tek fushat e tij kryesore të aktivitetit.

E njohur për prestigjin, besueshmërinë dhe strukturën e fortë financiare të demonstruar nga aktivitetet e vazhdueshme në zona të ndryshme gjeografike në botë, Çalik Holding bashkëpunon me shumë kompani globale dhe të fuqishme në nivelin ndërkombëtar. Grupi dallohet si lojtar kryesor dhe i fuqishëm në sektorët kryesorë në të cilët ai ushtron aktivitetin, dhe vijon të jetë i pranishëm në të gjitha fushat e biznesit që janë të përafëruara me objektivat e tij për rritje të qëndrueshme, me strukturën e konsoliduar të biznesit, me kulturën e pasur të kompanisë, me burimet njerëzore të kualifikuara, si dhe me iniciativat pioniere, qasjet novatore dhe strategjitë e sakta.



MOMENTE TË RËNDËSISHME

Duke qenë banka më e vjetër tregtare dhe ofruesi i parë i shërbimeve financiare në vend, BKT ka eksperiencë me rrënjë të thella, njohuri të thelluar lokale, si dhe një qasje shumë novatore të mbështetur nga vizioni i saj.

1925

Inaugurimi i selisë së bankës në Durrës më 30 nëntor 1925.

1993

Krijimi i Bankës Kombëtare Tregtare (BKT) në janar të vitit 1993, pas bashkimit të Bankës Tregtare Shqiptare (BTSH) dhe Bankës Kombëtare të Shqipërisë (BKSH).

1997

Banka Kombëtare Tregtare (BKT) u krijua si shoqëri aksionere në korrik 1997, me aktive që arrinin vlerën e 2.7 miliardë lekëve.

2000

Banka Kombëtare Tregtare (BKT) përfundoi procesin e privatizimit. Aksionerët e rinj investuan 10 milionë dollarë amerikanë, gjë e cila çoi në një kapital më të fortë të Bankës.

2001

Struktura e aksionerëve të rinj i solli transformime të mëdha BKT-së, duke përfshirë zhvillimin e një infrastrukture të re dhe ristrukturimin e të gjitha operacioneve të Bankës.

2006

60% e aksioneve të BKT-së iu transferuan Çalik-Şeker Konsorsiyum Yatırım A.Ş.

BKT mori çmimin "Banka më e Mirë e Vitit" nga revista "The Banker".

2007

BKT hap një degë të re në Prishtinë, Kosovë, në nëntor të vitit 2007, duke realizuar kështu investimin e parë të huaj të saj.



2009

BKT u bë 100% degë e Çalik Group pas blerjes së pjesës së mbetur të aksioneve nga Çalik Finansal Hizmetler.

BKT u vlerësua si "Banka më e Mirë në Europën Juglindore për vitin 2009".

2010

BKT festoi 10 vjetorin e privatizimit të saj.

BKT festoi 85 vjetorin e hapjes së Degës së Durrësit.

BKT mori çmimin "Banka më e Mirë e Vitit në Shqipëri" nga revista "The Banker".

2011

BKT bëhet banka e parë shqiptare që e shtrin kreditimin e saj në nivel ndërkombëtar.

BKT cilësohet nga "The Banker" si "Banka e Vitit" për Shqipërinë për vitin 2011.

EMEA Finance e cilëson po ashtu BKT-në si "Banka më e Mirë në Shqipëri për vitin 2010".

BKT nënshkruan një marrëveshje financimi me Korporatën Islamike Tregtare dhe Financiare (ITFC). Sipas kësaj marrëveshje, grupi kryen transaksionin e parë murabaha në Shqipëri.

NË VITIN 2013 BKT
MERR ÇMIMIN
"BANKA MË E
MIRË NË SHQIPËRI"
NGA REVISTA
"EUROMONEY".

2012

BKT merr çmimin "Banka më e Mirë në Shqipëri" nga Revista "Euromoney".

EMEA Finance e vlerëson BKT-në si "Banka më e Mirë në Shqipëri për Vitin 2011".

BKT merr "Çmimin e Ekselencës për vitin 2011 për Straight-Through-Processing (STP)" nga Wells Fargo.

JCR Eurasia Rating riafirmon vlerësimin AAA(Alb) për BKT-në për të katërtën herë radhazi.

JCR Eurasia Rating i jep BKT-së vlerësimin për qeverisjen e korporatave "AA(Alb)/Merit".

BKT hedh në treg tre produkte të reja – kreditë BKT AGRO, të projektuara posaçërisht për të plotësuar nevojat e sektorit bujqësor dhe nevojat për financim.

Nënshkruhet një marrëveshje me Fondin "Green for Growth" për një kredi me vlerë 15 milionë euro për financim të projekteve në industrinë energjitike.

Krijohet dega shqiptare e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë (ICC). Kryetar i saj zgjidhet Drejtori i Përgjithshëm BKT-së.

Arrihet me Korporatën Islamike për Zhvillim të Sektorit Privat një marrëveshje aksionere për krijimin e një kompanie kredihënëse që do të operojë sipas parimeve islamike.

2013

BKT merr çmimin "Banka më e Mirë në Shqipëri" nga Revista "Euromoney".

The Banker e vlerëson BKT-në si "Banka më e Mirë në Shqipëri për vitin 2013".

EMEA Finance e vlerëson BKT-në si "Banka më e Mirë në Shqipëri për Vitin 2012".

EMEA Finance e përzgjedh Drejtorin e Përgjithshëm të BKT-së si "CEO i Vitit 2013 në Europën Juglindore".

BKT merr "Çmimin e Ekselencës për vitin 2012 për Straight-Through-Processing (STP)" nga Wells Fargo.

JCR Eurasia Rating riafirmon vlerësimin AAA(Alb) për BKT-në për të pestën herë radhazi.

JCR Eurasia Rating i jep BKT-së vlerësimin për qeverisjen e korporatave "AA(Alb)/Merit".

BKT hedh në treg një produkt të ri "Kredi me Kolateral Çekun", kredia e parë dhe e vetme e këtij lloji në Shqipëri.

BKT hedh në treg Kreditë e Gjelbër për Bizneset dhe Individët, një produkt kredie i projektuar posaçërisht për eficientë e energjisë.

BKT merr pjesë në një kredi të përbashkët me kufi kredie prej 7 milionë eurosh, pjesë e një totali prej 106 milionë euro, kryesuar nga IFC.

BORDI DREJTUES





Mehmet Usta
Kryetar



Mehmet Ertuğrul Gürler
Zëvendës Kryetar



Ismail Hakkı Ergener
Anëtar Bordi



İzzet Serhat Demir
Anëtar Bordi



Seyhan Pencablıgil
Drejtor i Përgjithshëm dhe Anëtar i Bordit Drejtues

MENAXHIMI I LARTË





Seyhan Pencabligil
Drejtör i Përgjithshëm dhe Anëtar i Bordit Drejtues



Abdurrahman Balkiz
Grupi i Operacioneve
Drejtör Grupi



Aydın Argin
Grupi i Bankingut Tregtar dhe i Korporatave
Drejtör Grupi



Kaan Pekin
Grupi i Thesarit dhe i Institucioneve Financiare
Drejtör Grupi



Skënder Emiri
Grupi i Financës dhe TI
Drejtör Grupi



Ndue Maluta
Grupi i Menaxhimit të Riskut
Drejtör Grupi



Fatih Karli
Grupi i Bankingut Individual
Drejtör Grupi



Natasha Ahmetaj
Divizioni i Rrjetit
Drejtore Divizioni



Ibrahim Yaşar
Grupi i Auditit të Brendshëm
Drejtör Grupi

MESAZHI I KRYETARIT



BANKA ME RRËNJËT
MË TË THELLA NË
SHQIPËRI, BANKA
MË NOVATORE DHE
BANKA MË E MIRË
"NDËR MË TË MIRAT"

Duke u distancuar si banka e vetme në sektorin e saj që ka rritur nivelin e fitimit dhe pjesën e tregut çdo vit, BKT ka vijuar të rritet fuqishëm pavarësisht nga të gjitha rrethanat ekonomike.

Pavarësisht nga sfidat ekonomike në shtetet fqinje, Shqipëria e ka bërë dallimin për shkak të dinamikave të saj të brendshme. Megjithëse kriza ekonomike në Itali dhe në Greqi, vende në të cilat jetojnë shumë emigrantë shqiptarë, ka pasur një ndikim të madh mbi prurjet e remitancave në Shqipëri, ekonomia shqiptare ia ka dalë mbanë në ruajtjen e niveleve pozitive të rritjes.

Sipas Raportit të Investimeve të Bankës Botërore për vitin 2013, Shqipëria renditet në vendin e parë lidhur me tërheqjen e investimeve të huaja direkte, duke dëshmuar për performancë edhe më të mirë sesa fuqitë ekonomike të Europës Juglindore.

Megjithëse Turqia nuk zë pjesën më të madhe të biznesit të ndërtimit dhe të investimeve të drejtpërdrejta të bëra në Shqipëri, pjesëmarrja e saj në të dy këto zëra është rritur më shumë sesa pjesëmarrja e çdo vendi tjetër gjatë viteve të fundit. Investimet e drejtpërdrejta të Turqisë në Shqipëri e tejkaluan shumën e 1 miliardë dollarëve amerikanë në gjysmën e parë të vitit 2013, duke mbuluar më shumë se 10% të stokut të investimeve të drejtpërdrejta të Shqipërisë.

Pas ndryshimit të qeverisjes, për shkak të zgjedhjeve të përgjithshme parlamentare të vitit 2013, partia e re qeverisëse deklaroi se Turqia do të ishte partner strategjik, së bashku me Italinë dhe Greqinë, për shkak të kontributeve të investitorëve turq, të cilët kanë sjellë prurje të konsiderueshme në vend dhe kanë rritur punësimin në Shqipëri, pavarësisht mjedisit mbizotërues të krizës financiare.

Pikërisht në këtë vit të vështirë, përveç të qenit Banka shqiptare me rrënjët më të thella ne ishim dhe Banka më novatore dhe banka e "më të mirëve", duke e rritur pjesën e tregut në 22%. BKT është aktualisht një ndër dy bankat më të mëdha në Shqipëri me 2.7 miliardë dollarë amerikanë total aktivesh e dhe me 2.2 miliardë dollarë depozita. Duke ju shërbyer klientëve nëpërmjet 84 degëve (60 në Shqipëri dhe 24 në Kosovë), performanca e suksesshme e Bankës sonë është njohur po ashtu dhe nga agjenci ndërkombëtare vlerësimi - BKT mbetet banka më e vlerësuar në Shqipëri.

Në vitin 2013 BKT-së iu dha sërish çmimi i "Bankës më të Mirë në Shqipëri", çmimi i dhënë nga botuesit më prestigjiozë ndërkombëtarë financiarë - "The Banker", "Euromoney" dhe "EMEA Finance". Për më tepër, Drejtori i Përgjithshëm i BKT-

së, Seyhan Pencabligil, u përzgjedh po ashtu si "CEO i Vitit 2013 për Europën Juglindore" si shprehje e suksesit të BKT-së në rajon. Dhënia e çmimit të "Bankës më të Mirë në Shqipëri" tre herë brenda katër viteve nënvizon rolin domethënës të BKT-së dhe kapacitetin e fortë të saj në sistemin bankar në Shqipëri si bankë që është drejtuese në treg për sa i përket cilësisë, menaxhimit dhe shërbimeve novatore, pavarësisht kushteve sfiduese në ekonominë shqiptare.


Banka jonë e ruajti vlerësimin për qeverisjen e korporatës AA(Alb)/Merit për vitin 2013, e dhënë nga JCR, duke qenë i pari dhe i vetmi institucion që ka marrë një vlerësim të tillë në Shqipëri.

Gjatë vitit 2013, në përputhje me qasjen tonë për qëndrueshmëri, ne kemi miratuar projekte hidrocentralesh shtesë dhe kemi hedhur në treg një produkt të ri "KREDITË E GJEBRA" në bashkëpunim me GGF, duke e zgjeruar portofolin tonë për energji të rinovueshme.

Brenda kuadrit të politikave tona të përgjegjësisë sociale, ne mbështesim zhvillime të vazhdueshme sociale dhe kulturore nëpërmjet projekteve tona, duke investuar në këtë mënyrë në të ardhmen e vendit tonë. Ne po ashtu kontribuojmë në disa aktivitete lidhur me rritjen e ndërgjegjësimit për rëndësinë e mjedisit dhe gjelbërimit.

Duke u distancuar si banka e vetme në këtë sektor që e ka rritur fitimin dhe praninë e saj në treg çdo vit, BKT ka vijuar të rritet fuqishëm pavarësisht të gjitha rrethanave ekonomike. Një ndër forcat tona më të mëdha shtytëse është bindja që shqiptarët meritojnë më shumë dhe një cilësi më të mirë për gjithçka, duke përfshirë dhe shërbimet bankare.

Dëshiroj të përfitoj nga rasti të falenderoj përzemërisht skuadrën tonë profesionale për mbështetjen e saj, e cila e ka çuar BKT-në një hap më përpara, si dhe klientët tanë, të cilët gjithmonë u kanë besuar energjive dhe kapaciteteve tona.



Mehmet Usta
Kryetar

MESAZHI I DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM



RRITJE E
QËNDRUESHME DHE
PËRFITUESHMËRI
EDHE NË KOHËRA TË
VËSHTIRA

Fitimi dhe përfitueshmëria e lartë nënkuptojnë se BKT ka patur fitimin më të madh neto në sistemin bankar, duke e tejkaluar fitimin neto të kombinuar të dy bankave të tjera pasuese.

2013-i ishte viti më i vështirë në Shqipëri që prej fillimit të krizës globale financiare në vitin 2007. Përveç ngadalësimit të përgjithshëm të ekonomisë që e paralizoi të gjithë rajonin, Shqipëria organizoi dhe zgjedhjet parlamentare të cilat çuan në një qeveri të re. Pasiguria parazgjedhore vijoi me ndryshimet paszgjedhore në administratë, ndërkohë që ekonomia e ndali zhvillimin e saj. Ngadalësimi ekonomik është reflektuar dhe në shifrat e sistemit bankar, i cili i rriti aktivet e tij të përgjithshme me më pak se 4%, ndërsa kreditë bankare u tkurrën me 2%. Kreditë e këqija në sistem arritën nivelin më të lartë të të gjitha kohërave - në 25%.

Aspekti pozitiv ishte që zgjedhjet shkuan mirë dhe qeverisja u ndryshua normalisht, ndërkohë që qeveria e re ra dakord me FMN-në, Bankën Botërore dhe BE-në për financim afatgjatë, efektet e së cilit do të ndihen në vitin 2014.


BKT ka pati një vit shumë të suksesshëm, veçanërisht parë në kuadrin e këtij sfondi.

Ne i rritën aktivet tona të përgjithshme me 15% në vitin 2013, ndërkohë që fitimi neto ishte 39.3 milionë dollarë amerikanë, duke korresponduar me një rritje prej 27% nga një vit më parë. Kapitali aksioner arriti në shifrën 215 milionë dollarë amerikanë, duke përkuar kështu me 17% kthim mbi kapitalin aksioner. Duhet ta pranojmë se ky nivel është më i ulët sesa mesatarja afatgjatë, por është i mirë krahasueshëm me konkurrentët tanë.

Niveli i lartë i përfitueshmërisë nënkupton që BKT ka po ashtu nivelin më të lartë të fitimit neto në sistemin bankar, duke i tejkaluar fitimet neto të kombinuara të dy bankave të tjera pasuese. Po ashtu, ne shënuam nivelin më të ulët të kredive të këqija mes bankave të krahasueshme me ne, me afërsisht një të tretën e saj çfarë përfaqësohet nga sistemi.

Rritja dhe përfitueshmëria jonë e qëndrueshme edhe në kohë të vështira është vlerësuar me çmime të ndryshme ndërkombëtare, dhe reflektuar në pjesët e tregut, të cilat janë rritur në të gjitha segmentet. Ne tani kemi 22% të sistemit bankar, duke qenë shumë afër objektivit tonë të 25% të sistemit deri në vitin 2015.

Ne presim një rimëkëmbje graduale në ekonominë shqiptare në vitin 2014, ndaj të cilës BKT është e pozicionuar në mënyrë perfekte që të përfitojë. Ne kemi likuiditet dhe kapital të mjaftueshëm për të nxitur rritjen ekonomike të vendit të mbështetur nga huamarrja ndërkombëtare. Duke qenë kështu, ne planifikojmë një bilanc total në mbi 3 miliardë dollarë amerikanë në vitin 2014 dhe të ardhura përmbledhëse prej 50 milionë dollarësh. Kjo korrespondon me një kthim mbi kapitalin prej 23% dhe mbetet e arritshme, pavarësisht se agresive, falë udhëzimeve progresive të ofruar nga Bordi Drejtues dhe nga puna e madhe dhe dedikimi i anëtarëve të stafit, të cilëve vërtetë u jam shumë mirënjohës.



Seyhan Pencabliligil
Drejtor i Përgjithshëm & Anëtar i Bordit

ÇMIMET DHE VLERËSIMET GJATË VITIT 2013

Çmimet

- BKT citohet në vitin e dytë radhazi si “Banka më e Mirë në Shqipëri” për vitin 2013 nga revista Euromoney.
- EMEA Finance e vlerëson BKT-në si “Banka më e Mirë në Shqipëri për Vitin 2012”. Ky është viti i tretë radhazi që Banka vlerësohet me këtë çmim.
- EMEA Finance e vlerëson Z. Seyhan Pencabligil, Drejtorin e Përgjithshëm të BKT-së si “CEO i Vitit 2012 për Europën Juglindore”.
- Revista The Banker riafirmon BKT-në si “Bankën më të Mirë në Shqipëri” për vitin 2013.
- BKT merr “Çmimin e Ekselencës për vitin 2012 për procesimin e pagesave (STP)” nga Wells Fargo, një ndër bankat më të mëdha në Shtetet e Bashkuara.

Vlerësimet

- Në vitin 2013 JCR Eurasia Rating riafirmon për të pestën herë vlerësimin AAA(Alb) për BKT-në, duke shtuar se Banka ka një situatë të qëndrueshme, gjë e cila dëshmon nivelin më të lartë të investimit. JCR-ER e rikonfirmoi vlerësimin afat-gjatë ndërkombëtar të monedhës vendase të BKT-së në “BB+”.
- Mbi bazën e vlerësimit të praktikave të qeverisjes së korporatës të krijuara nga BKT, JCR-ER i jep BKT-së për të dytën herë radhazi vlerësimin për qeverisjen e korporatës me notën “AA(Alb)/Merit” për përputhshmërinë e saj të plotë me Kodin Shqiptar të Qeverisjes së Korporatave dhe me rregulloret e përcaktuara nga Ministria e Financës së Shqipërisë. Ky është vlerësimi i parë i këtij lloji që i është dhënë ndonjëherë një kompanie shqiptare.

CEO i Vitit 2012 për
Europën Juglindore
EMEA FINANCE

Bankën më të Mirë në Shqipëri
THE BANKER

Bankën më të Mirë në Shqipëri
EUROMONEY

Bankën më të Mirë në Shqipëri
EMEA FINANCE





Ceremonia e Çmimeve të EMEA Finance – qershor 2013



Ceremonia e Çmimeve të Euromoney – korrik 2013



Ceremonia e Çmimeve të The Banker – nëntor 2013

BKT KOSOVA

BKT Kosova ka tregoi një rritje të qëndrueshme gjatë të gjithë vitit 2013. Banka vazhdoi në vitin 2013 të prezantonte produkte dhe shërbime të reja, si dhe e zgjeroi gamën e produkteve dhe të shërbimeve për klientët duke investuar në kanale që plotësojnë më mirë nevojat e klientëve.

Në vitin 2013, aktivet gjithsej u rritën me 14.6%, duke arritur në 220 milionë euro, ndërkohë që depozitat u rritën me 11%, duke arritur në 196 milionë euro. Kreditë gjithsej kapën shifrën e 96 milionë eurosh, ndërkohë që fitimi neto për vitin 2013 ishte 67 mijë euro.

Banka Tregtare Kombëtare njihet në tregun kosovar për arritjet e saj, duke përfshirë produktet e saj novatore, individët e pashembullt, iniciativat e qëndrueshmërisë dhe kontributet e bamirësisë për shoqërinë. Banka është e angazhuar të forcojë më tej identitetin e saj nëpërmjet praktikave të plota të qeverisjes së korporatës, si dhe duke ruajtur pozicionin e saj drejtues në treg në prezantimin e produkteve të reja dhe në të qenurit e veçantë në aspektin e ofrimit të shërbimeve të saj për të arritur kënaqësitë e klientëve të saj.

Gjatë vitit 2013, BKT Kosova nënshkroi një kontratë me Fondin Europian të Europës Juglindore (EFSE) për të përdorur një limit kredie prej 10 milionë eurosh. Nëpërmjet kësaj

marrëveshje, BKT do të ofrojë mbështetje të mëtejshme për SME-të dhe Agrobiznesin, të cilat do të kenë ndikim domethënës në zhvillimet e shpejta të ekonomisë kosovare.

BKT Kosova udhëhiqet nga një ndërgjegjësimit i lartë për përgjegjësinë sociale të korporatave, bazuar në parimin e "kontribuimit për shoqërinë". Gjatë vitit 2013, Banka ka vijuar të kontribuojë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë dhe të mbështesë arsimin, sportin, artin dhe kulturën në Kosovë, si dhe aktivitete të ndryshme sociale.

Banka është plotësisht e dedikuar për kultivimin e kulturës së duhur dhe krijimin e një modeli të qëndrueshëm biznesi që do të krijojë vlerë aksionere afatgjatë. Objektivat kryesore të BKT Kosovës janë zhvillimi i burimeve njerëzore nëpërmjet trajnimit të vazhdueshëm të stafit, si mbikëqyrjes dhe aktiviteteve të zhvillimit të cilat do të bëjnë të mundur rritjen afatgjatë dhe zhvillimin e karrierës. Angazhimet kryesore të BKT Kosovës do të jenë përgjigja ndaj kuadrit rregullator, krijimit dhe mbajtjes së marrëdhënieve afatgjata me klientët, ofrimi i një game të gjerë produktesh konkurruese dhe i shërbimeve me standard më të lartë.

Në vitin 2013, numri i të punësuarve arriti në 274.



Abdurrahman Balkiz
Drejtor BKT Kosova



Cenk Ariöz
Zëvendës Drejtor BKT Kosova



Hakan Özat
Drejtor i Grupit të Auditit



Mete Aytekin
Drejtor i Grupit të Bankingut Individual








Rudin Lleshaj
Drejtor i Grupit të Operacioneve




Albion Mulaku
Drejtor i Grupit të Bankingut Tregtar dhe Korporatave

BKT KOSOVA NË SHIFRA

TOTALI I AKTIVIT
(EUR MILIONË)HUATË
(EUR MILIONË)TOTALI I DEPOZITAVE
(EUR MILIONË)PJESA E TREGUT PËR
TOTALIN E AKTIVIT (%)FITIMI NETO
(EUR MILIONË)

NUMRI I DEGËVE



Në vitin 2013, aktivet gjithsej u rritën me 14.6%, duke arritur në 220 milionë euro, ndërkohë që depozitat u rritën me 11%, duke arritur në 196 milionë euro. Kreditë gjithsej kapën shifrën e 96 milionë eurosh, ndërkohë që fitimi neto për 2013 ishte 67 mijë euro.

PJESA E TREGUT
TË BKT-SË PËR
BANKINGUN
INDIVIDUAL U RRIET ME
2.7 PIKË PËRQINDJE,
DUKE ARRITUR NË
18%, DUKE U BËRË
LIDER I SEKTORIT.



0% **intereses**
për vitin e parë



VLERËSIMI PËR AKTIVITETET E VITIT 2013

BANKINGU INDIVIDUAL

Ruajtja e pozicionit lider në sektor për vitin 2013

Pavarësisht nga mjedisi i një tregu në stanjacion në vitin 2013, BKT vijoi rritjen e bazës së kredisë për individët, e cila arriti në 253 milionë dollarë amerikanë, me 18% rritje nga viti paraardhës. Në segmentin e kredive për individët, pjesa e tregut e BKT-së u rrit me 2.7 pikë përqindje, duke arritur nivelin e 18% dhe duke marrë pozicionin lider në këtë aspekt në gjysmën e parë të vitit në Shqipëri. Sipas shifrave të konsoliduara, duke përfshirë dhe Kosovën, BKT ka 21.1% të tregut dhe një pozicion të fortë lidhshipi.

Shtytësi kryesor i rritjes në zërin e kredive për individët ishte qasja agresive, e cila u mbështet me produkte të reja në kredi hipotekore. Në vitin 2013, pjesa e tregut për kreditë hipotekore ishte 21% (53.5% vetëm në tregun në Lekë).

Gjenerimi i kredive hipotekore, me 5% interes për vitin e parë, Bono Thesari + interes dhe 0% interes gjatë pesë viteve të fundit ofroi një avantazh gjithëpërfshirës në treg.

Volumet e paradhënies bankare u rritën me 23%, paralelisht me rritjen prej 20% të llogarive të pagave në vitin 2013, mbështetur në penetrimin tek klienti nëpërmjet shitjeve të kryqëzuara.

Kreditë për individë në vitin 2013 u rritën me ndihmën e marketingut më dinamik dhe produkteve të reja në treg. Brenda kuadrit të kredive për individët, u hodhën në treg në vitin 2013 produktet e mëposhtme:

- Kreditë për pensionistë të cilët i marrin pensionet nëpërmjet BKT-së, me kusht që ata të mos e ndryshojnë bankën;
- Kreditë e gjelbra, të cilat ofrojnë një zbritje me 20% të interesit për një nivel të caktuar të kursimit të energjisë;
- Kreditë hipotekore për klientët e besueshëm mbështetur në të njëjtin kolateral.

KREDITË PËR INDIVIDË NË VITIN 2013 U RITËN ME NDIHMËN E MARKETINGUT MË DINAMIK DHE PRODUKTEVE TË REJA NË TREG.



Karta Prima është e vetmja kartë krediti në vend e cila ofron këste dhe një program besnikërie.

Karta Prima është sërish lider me veçori të reja

Karta Prima e BKT-së, programi i parë në Shqipëri i kartës së kreditit bazuar në këste, në vitin 2013 ka qenë karta më e preferuar, duke u përditësuar me Prima Extra e cila ofron bonuse dhe Prima Falas, e cila ofron lotarinë që bën të mundur eksperiencën e blerjes pa pagesë për një fitues çdo ditë. Në vitin 2013 numri i përgjithshëm i kartave të kreditit të lëshuara nga BKT u rrit me 61%, duke arritur në mbi 23 mijë karta. Po ashtu, vitin që shkoi ka pasur një rritje prej 41% në volumin e transaksioneve të kartave të kreditit të Bankës, ndërkohë që blerjet me këste janë rritur me 110%. BKT është lider në tregun e brendshëm lidhur me numrin e kartave të kreditit të hedhura në qarkullim, numrin dhe volumin e transaksioneve, me respektivisht 35%, 35% dhe 24% të tregut.

20.38% pjesë tregu të numrit të transaksioneve në pikat e shitjes (POS-e).

Gjatë këtij viti u bë punë e konsiderueshme për të rritur efikasitetin e operacioneve me partnerët tregtarë, terminalat jo aktive u zëvendësuan, ndërsa u kryen edhe studime efektive marketimi. BKT arriti në 1,597 terminale POS, duke shënuar 18% rritje në vitin 2013. Banka e rriti pjesën e saj të tregut lidhur me numrin dhe transaksionet në POS në 20.38% dhe 13.93% (nga 8.48%).respektively.



Fushata e tregtisë: Paguaj me Kartën Prima dhe merr një shishe Coca Cola.

MIRË PËR JU.
MIRË PËR SHQIPËRINË.

KREDI E GJELBËR

PËR INDIVIDË



**20% më pak interes për kredi
që ju të kurseni 20% energji**

VLERËSIMI PËR AKTIVITETET E VITIT 2013

33% të tregut për pagimin e faturave utilitare

Për shërbimin e pagimit të faturave utilitare BKT ka sistemet më gjithëpërfshirëse në treg si dhe ka tërhequr kompanitë më të mëdha të shërbimeve në Shqipëri. Ndërkohë që për vitin 2013 Banka ka përpunuar mbi 31 mijë pagesa faturash, është arritur 1/3 e tregut për transaksionet e pagesave.

Kemi zgjeruar bazën e klientëve nëpërmjet përdorimit të Kanaleve Alternative të Shpërndarjes

BKT i jep gjithmonë e më shumë rëndësi integritimit të kanaleve alternative të shpërndarjes (ADCH) në procese ofrimi produktesh dhe shërbimesh duke ofruar akses dhe ritëm të shpejtë. Në vitin 2013 u morën hapa të rëndësishëm për të përmirësuar ADCH-të në përputhje me këtë qëllim.

Numri i klientëve individë që përdorin aktivisht shërbimet bankare të BKT-së e ka kaluar shifrën 4,187 vetë, duke u rritur me 35.41% në vitin 2013 në Degën e Internetit, e cila pranohet si dega më funksionale e bankingut në internet në treg. Numri i abonentëve online për bankingun individual është rritur me 37%, duke arritur në 17,853 vetë, duke zënë 18% të tregut.

Janë prezantuar shumë risi në këtë sektor, ndërkohë që lloji i transaksioneve në këtë kanal është rritur në vitin 2013, duke rritur po ashtu dhe numrin e klientëve aktivë. BKT ishte banka e parë që u bë bankë ndërmjetëse në pagesat e-paguaj. Për më tepër, pagesat e-dogana mund të kryhen nëpërmjet këtij kanali, ndërkohë që nëpërmjet kartës mund të aktivizohen dhe abonimet dixhitale televizive. BKT ka sjellë novacion dhe në e-commerce në vitin 2013; BKT është aktualisht e vetmja bankë që ofron lehtësira bonusi dhe këstesh nëpërmjet sistemeve virtuale POS.

BKT është banka e parë dhe e vetme në Shqipëri që prezantoi sistemin "3D Secure", i cili ofron një siguri më të lartë për transaksionet online për kartat e kreditit dhe të debitit.

Paralelisht me numrin e rritur të korporatave të përfshira në shërbimin e pagesave top-up në vitin 2013, të cilat realizohen me anë të internetit, numri i transaksioneve ka vijuar të rritet.

BKT renditet e dyta në Shqipëri për sa i përket ATM-ve. Numri i njësive në rrjetin e Bankës është rritur me 3.5% duke kapur shifrën 89 deri në fund në vitin 2013, ndërkohë që numri dhe volumi i transaksioneve të ATM-ve është rritur përkatësisht me 16% dhe 14.5%. Banka ka aktualisht 17% të tregut lidhur me transaksionet e ATM-ve.

Po ashtu, gjatë vitit që shkoi BKT ka shënuar rritje të SMS-ve në përdorimin ADCH. Numri dhe volumi i kredive konsumatore me SMS u rrit me përkatësisht 150% dhe 15%.



BKT ËSHTË E PARË
DHE E VETMJA BANKË
E CILA APLIKON
SISTEMIN "3D
SECURE".

PAVARËSISHT
VËSHIRËSIVE REALE
DHE PENGESAVE TË
HASURA NË TREG,
BKT KA MBETUR
BANKË UNIKE DUKE
SJELLË NOVACION
NË PRODUKTE DHE
SHËRBIME.

ACD
Assurance Company Insurance Agency



VLERËSIMI PËR AKTIVITETET E VITIT 2013

BANKINGU TREGTAR DHE I KORPORATAVE

Vazhdim i rritjes pavarësisht situatës së vështirë

Pavarësisht vështirësive reale dhe pengesave të hasura në treg, BKT ka vijuar të qëndrojë e patundur në financimin e projekteve të qëndrueshme dhe fizibël, në financimin e klientëve të biznesit, projektet e hidrocentraleve dhe SME-ve në përputhje me politikat e saj të huadhënies.

Portofoli i korporatave u rrit me 3.29% në vitin 2013 duke arritur në 365.1 milionë dollarë amerikanë, duke e realizuar planin me 92.97%.

Portofoli tregtar e realizoi objektivin e tij me 83.90%. Volumet e kredive tregtare arritën shifrën e 176.2 milionë dollarësh amerikanë, ndërsa kreditë publike shënuan një nivel realizimi prej 102.9%, një tepri prej 66.1 milionë dollarësh dhe një rritje të përgjithshme prej 2.88%.

BKT kishte 14.5% të kredive të bizneseve/tregtare në treg në vitin 2013, duke u renditur e treta në sektor për këtë zë.

Të përqendruar në uljen e riskut nga këmbimi i monedhave të huaja në operacionet tona kredihënëse dhe në përputhje me orientimin tonë për kredi në monedhën vendase, pesha e huave në lekë në portofolin e korporatave dhe të tregtisë u rrit nga 39.9% në dhjetor të vitit 2012 në rreth 43.5% deri në fund të vitit 2013.

Fleksibiliteti lidhur me afatet dhe kushtet, sinkronizimi ndërmjet grupeve bankare ndërvepruese, si dhe theksi mbi shitjet e kryqëzuara janë përkthyer në një rritje prej 44% dhe 48% në numrin e klientëve Tregtarë dhe të Korporatave; rritje përkatëse prej 25% dhe 82% në numrin e kompanive publike dhe private të cilat i paguajnë pagat nëpërmjet BKT-së; dhe rritje 23% në përdorimin e POS-eve krahasuar me një vit më parë.

BKT ruajti pozicionin e saj si banka e dytë në vitin 2013 me 22% të tregut lidhur me kreditë jo cash, duke ruajtur të njëjtin pozicion si një vit më parë, por me një volum portofoli që e tejkalon më shumë se dy herë konkurruesin më të afërt.

Një gamë produktesh dhe shërbimesh të reja të dallueshme

- Volumi i paradhënies bankare që u ofrohen klientëve të korporatave dhe atyre tregtar u rrit me 399% për të arritur totalin prej 18.7 milionë dollarë amerikanë.
- Brenda kuadrit të Kredisë së Koletarizuar me Çek, produkt novator ekskluziv i BKT-së për sektorin bankar në Shqipëri, janë dhënë gjithsej 13 kredi me shumën totale prej 2.3 milionë dollarësh.
- Numri i kompanive të regjistruara në E-banking është rritur me 257% krahasuar me dhjetorin e vitit 2012, për të arritur në 888 dhe realizuar një total prej 39,701 transaksionesh gjatë gjithë vitit.



Seminar informativ lidhur me alternativat e përdorimit të çeqeve.

Vëmendje e posaçme tek financimi i projekteve

Fondet e ofruara nga burimet e Bankës dhe korporatat ndërkombëtare kanalizohen në sektorin e energjisë dhe të investimeve në hidrocentrale nëpërmjet projekteve për përdorimin e burimeve të energjisë së rinovueshme nëpërmjet Departamentit të Projekteve dhe Financës së Strukturuar, i cili është ristrukturuar kohët e fundit.

Projekti GGF, i cili financon projektet e energjisë së rinovueshme, renditet në pararojë si një ndër bashkëpunimet më të rëndësishme në këtë fushë.

Projekte të tjera shtesë në fushën e hidrocentraleve janë miratuar gjatë vitit 2013, duke e çuar portofolin e energjisë së rinovueshme në totalin prej 28 milionë dollarësh amerikanë.

Projekti i parë i hidrocentraleve që do të vendoset në skemën e portofolit GGF RE pas plotësimit të kriterëve për kryerjen e investimit të duhur korrespondon me një kredi prej 8.4 milionë eurosh.

Kredia e parë e përbashkët e BKT-së

BKT ka marrë pjesë në një kredi të përbashkët me një kufi kredie prej 7 milionë eurosh, pjesë e një pakete kredie prej 106 milionë eurosh, ku banka lider është IFC. Paketa e financimit do të përdoret për të financuar marrjen dhe financimin e katër hidrocentraleve për prodhimin e energjisë elektrike.



Marrëveshje e Re për Garanci Kredie me Bashkinë e Tiranës.

NË VITIN 2013 BKT VIJOI TË FINANCONTE
PROJEKTE TË QËNDRUESHME DHE FIZIBËL
NË SEKTORIN PRIVAT, PËR KLIENTËT E
KORPORATAVE, HIDROCENTRALET DHE
SME-TË NË PËRPUTHJE ME POLITIKAT E
SAJ KREDIDHËNËSE.



DREJTUESIT E BKT-SË NË NJË VIZITË KLIENTI NË KOSOVË.

VLERËSIMI PËR AKTIVITETET E VITIT 2013

Produkt i ri i gjelbër

Një produkt i ri kredie "KREDI E GJELBËR PËR BIZNESIN" (GGF) u hodh në treg brenda kuadrit të marrëveshjes së nënshkruar nga BKT me GGF-në, me një kredi të varur prej 10 milionë eurosh. Banka ka dhënë kredi prej 830,000 eurosh 11 firmave brenda këtij kuadri.

SME-të janë gjithnjë në qendër të vëmendjes sonë

BKT e konsideron mbështetjen e SME-ve me burime të lira dhe me mundësi financimi nga jashtë si një ndër objektivat e saj strategjikë.

Kreditë për Programin Italian të SME-ve vijuan dhe në vitin 2013. BKT është banka lider e këtij programi me 42 klientë (49%) nga 83 klientë që marrin pjesë në program dhe me 7.3 milionë disbursime (39.9% e totalit prej 18,313,955 eurosh).

Kreditë për Projektin EFSE kanë vijuar në mënyrë të suksesshme dhe në vitin 2013. U miratua një total prej 20 milionë eurosh nga EFSE (Fondi European për Europën Juglindore) për BKT-në në shtator të vitit 2010. Fondi u riciklua duke arritur një disbursim të përgjithshëm të kredisë prej 25 milionë euro. Në fund të vitit 2013, maturiteti mesatar i 25 milionë eurove kredi që iu dhanë 461 SME-ve ishte 40 muaj.

Arritje e volumeve të larta në bashkëpunim me ndërmarrjet publike

BKT u përzgjedh si banka partnere nga Bashkia e Tiranës. Ndërmjet saj dhe Bashkisë së Tiranës u nënshkrua një Marrëveshje për Garanci Kredie, nëpërmjet së cilës Banka synon të rrisë kontributin e saj për zhvillimin ekonomik të qytetit, si dhe të prezantojë më shumë klientë në Bankë. Brenda këtij kuadri, BKT prezantoi dy produkte të reja kredie me nivele interesi shumë preferenciale (një nivel fiks prej 5% dhe një nivel prej 5.5% për kreditë në lek) dhe me kërkesa të ulëta për kolateralin, ku Bashkia do të garantojë nga 10 deri në 50% të shumës së kredisë. Deri tani janë miratuar shtatë aplikime të bëra bazuar në këtë program me një total prej 115,000 dollarësh amerikanë në kredi.

BKT u përzgjedh si një ndër tre bankat partnere në Programin MIDF (Fondi e Zhvillimit të Infrastrukturës së Bashkive – i financuar bashkërisht nga BERZH dhe KFW) për ofrimin e shërbimeve financiare, duke përfshirë ndarjen e riskut me MIDF në lidhje me projektet bashkiake për investimet infrastrukturore.

BKT, e cila ofron kredi për korporatat publike dhe realizon një nivel të lartë transaksionesh me to, synon po ashtu përmirësimin e marrëdhënieve me ndërmarrjet publike në fushat e pagimit të pagave dhe të depozitave publike. Janë 555 ndërmarrje publike të cilat i kanalizojnë pagat e tyre nëpërmjet BKT-së. Për rrjedhojë, 31% e pagave të përgjithshme publike kalojnë nga BKT.

Mbështetje për bujqësinë me Kredinë BKT AGRO

Sektori i bujqësisë ka qenë në vëmendje të BKT-së gjatë të gjithë vitit 2013 nëpërmjet:

- Kredisë BKT Agro të projektuar në tri segmente si Kredi Agro Speciale, Kredi Mbështetje Agro dhe Kredi Agro.
- Bashkëpunimit me Programin e USAID-it në kuadër të Skemës së Garancisë.
- Sesioneve dhe seminareve të ndryshme të organizuara me agrobizneset në rajone të ndryshme.

Nëpërmjet programit të garancive me USAID-in, ofrohet një garanci 50% për kreditë bujqësore për një portofol të përgjithshëm kredie deri në 7.5 milionë dollarë amerikanë. Në vitin 2013, 36 klientë u financuan me 968,000 dollarë amerikanë kredi.

Projekti E-Sigurimet: projekt pararojë

Projekti E-Sigurimet është një tjetër projekt i rëndësishëm i realizuar në mënyrë të suksesshme gjatë vitit 2013. Projekti përbëhet nga shitja online e policave të sigurimit nëpërmjet sistemit të ndërmjetësimit të BKT-së dhe ofrimit të paradhënies bankare për agjentët e sigurimeve, të mbështetur me 50% mbulim cash nga Kompanitë e Sigurimeve. BKT, e cila bashkëpunon me të nënta kompanitë e sigurimeve që ekzistojnë në vend, ka ekskluzivitetin e TPL-ve, të kartonave të gjelbër dhe policave ndërkufitare dhe që prej fillimit të nëntorit të vitit 2013 sigurimi i detyrueshëm shitet vetëm nëpërmjet sistemit bankar dhe këto transaksione kryhen vetëm në BKT.

Një total prej 553 agjentësh aktivë kanë realizuar 198,279 transaksione në periudhën ndërmjet nëntorit 2012 dhe dhjetorit 2013 (të paktën një transaksion në muaj për çdo agjent) me një volum prej më shumë se 20.34 milionë dollarësh amerikanë.



Ceremonia e inaugurimit të shërbimeve e-paguaj.

NIVELI I KREDIVE TË
KËQIJA TË BKT-SË
MBETET ME PËRQINDJE
NJËSHIFRORE – NDËR
NIVELET MË TË ULTA
NDËRMJET BANKAVE.



BKT
BANKA KOMBETARE TREGTARE

VLERËSIMI PËR AKTIVITETET E VITIT 2013

THESARI DHE INSTITUCIONET FINANCIARE

Viti 2013 ishte një vit i vështirë për ekonominë shqiptare dhe sektorin bankar për shkak të rimëkëmbjes së kufizuar ekonomike në shtetet e Eurozonës dhe të rritjes së nivelit të pasigurisë si rezultat i zgjedhjeve të përgjithshme parlamentare. Kompetenca e Thesarit në përdorimin e instrumenteve në tregjet e parave dhe tregjet e kapitalit është reflektuar në nivelin e lartë të likuiditetit, aftësisë së tij për të ofruar mbrojtje të plotë kundrejt uljes së nivelit të fitimit dhe rolit të rëndësishëm të luajtur në arritjen e objektivave të Bankës.

BKT dallon nga pozicioni i saj aktiv në Eurobonde dhe në transaksione të tjera të lidhura dhe në kredi të përbashkëta. Për më tepër, BKT mbetet ende një ndër lojtarët kryesorë të tregut të këmbimit të parasë dhe të këmbimit të monedhave të huaja në vend. BKT është bërë banka numër një në vend për bonot lokale të thesarit dhe për letrat me vlerë respektivisht 23.7% dhe 30.5% të tregut.

BKT e ka zgjeruar bazën e klientëve të saj nëpërmjet marrëdhënieve të mbështetura në besim, të cilat promovojnë besnikërinë. Për pasojë, Banka zë 21.4% të tregut të depozitave në vend.

Si lojtare e respektuar në arenën ndërkombëtare, BKT ka hyrë në marrëdhënie të forta me bankat përkatëse dhe me institucionet ndërkombëtare financiare. Përfaqësuesit e BKT-së vizituan mbi 125 banka në shumë rajone të ndryshme gjatë vitit të fundit. Numri i bankave që kanë ofruar limite për BKT-në ka shkuar në 223. BKT, e cila po fiton një pjesë në rritje të tregtisë së huaj të vendit, ka shtuar shpejtësinë për rritjen e transaksioneve të tregtisë së huaj.

Pas marrjes së 10 milionë eurove nga kredia e varur prej 15 milionë eurosh për një periudhë shtatë vjeçare nga marrëveshje me Fondin "Green for Growth" në vitin 2012 për financimin e projekteve në fushën e energjisë, pritet që të përdoret pjesa e mbetur prej 5 milionë eurosh deri në fund të muajit mars 2014.

Numri i anëtarëve të degës shqiptare të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë (ICC) është rritur nga 4 në 19 persona, pas punës së ndërmarrë nën drejtimin e BKT-së, e cila e sheh këtë iniciativë si të rëndësishme për vendin. Baza e anëtarësisë është zgjeruar nëpërmjet pjesëmarrjes së firmave nga sektorët e teknologjisë së telekomunikacionit, energjisë, firmave ligjore dhe bankave.

Një kompani leasingu, aksionerët kryesor të së cilës janë Korporata Islamike për Zhvillimin e Sektorit Privat dhe BKT, ka filluar operacionet dhe transaksionet përkatëse.


GRUPI I MENAXHIMIT TË RISKUT

Konjunktura globale makro-ekonomike dhe ndikimet përkatëse mbi ekonominë e vendit shkaktuan një rritje të nivelit të kredive me probleme. Niveli i kredive me probleme në Shqipëri në vitin 2013 ishte 24.8%.

BKT ruajti raportet e ulëta të këtij niveli falë aftësisë së saj për ruajtjen e cilësisë së pasiveve, një politikë kredie që ka shmangur përqëndrimin e riskut dhe nxit shpërndarjen e riskut në bazë dhe menaxhimin efektiv të tij. Niveli i kredive me probleme të BKT-së është në përqindje njëshifrore, niveli më i ulët ndër bankat shqiptare.

BKT mund të konsiderohet e sigurt lidhur me kreditimin, tregun, likuiditetin dhe risqet operationale. Në vitin 2013 Banka rishikoi politikat dhe aplikimet e saj dhe konfirmoi përputhshmërinë me parimet e Basel II. Banka ka realizuar po ashtu disa teste stresi për tregun dhe riskun e nivelit të interesit dhe pas analizimit të tyre ajo rezultoi se ishte brenda parametrave.

BANKA ZË 21.4% TË TREGUT PËR DEPOZITAT



POLITIKA E BURIMEVE
NJERËZORE TË BKT-
SË FORMËSOHET MBI
BAZËN E "NJOHJES
SË PUNONJËSVE" SI
VLERË.



VLERËSIMI PËR AKTIVITETET E VITIT 2013

BURIMET NJERËZORE

Burimet njerëzore, kapitali intelektual i BKT-së, përbëhen nga punonjës të cilët reflektojnë më së mirë shpirtin e skuadrës së kompanisë, të cilët kanë objektiva që janë në përputhje me synimet e Bankës.

Në të gjithë procesin e rekrutimit, kandidatët vlerësohen bazuar në kompetencat dhe potencialin për zhvillim dhe përputhshmërinë e tyre me kulturën e të punuarit në Bankë, si dhe të qenit të hapur ndaj novacionit dhe ndryshimit. Me synimin e sigurimit të disponueshmërisë së stafit me cilësi të lartë gjatë gjithë kohës, ne kemi filluar të bëjmë një provim për ata që kërkojnë ngritje në detyrë nga asistent specialist në specialist.

Politika e Burimeve Njerëzore të BKT-së formësohen mbi bazën e "njohjes së punonjësve" si vlerë. Kjo politikë, e cila synon të prezantojë një karrierë më të fortë dhe një sistem me pagesë të drejtë për punonjësit, ndërtohet në shtyllat e mëposhtme bazë: mbështetje për zhvillimin individual dhe profesional të punonjësve, shpërblimin e arritjeve të tyre dhe përmirësimin e efikasitetit duke rritur motivimin. Në këtë kuadër, puna në skuadër nxitet për të krijuar një mjedis të shëndetshëm biznesi. Punonjësit mbështeten me një gamë të gjerë lehtësirash teknologjike dhe u jepet mundësia të përmirësojnë kompetencat e tyre nëpërmjet programeve të shumta të trajnimit. Gjatë vitit 2013 janë promovuar 17% e stafit të bankës.

Aktivitetet për trajnimin e stafit kanë vijuar dhe në vitin 2013, duke përfshirë një shumëllojshmëri programesh dhe seminaresh. Numri i programeve dhe i seminareve të trajnimit në vitin 2013 u rrit me 32%, ndërkohë që koha mesatare e sesioneve të trajnimit u rrit me 10%. Koha mesatare e trajnimit për person në vitin 2013 ishte 8.1 ditë, prej të cilave gjysma e trajnimeve ishin të përqendruar tek shitjet. Në vitin 2013 BKT bëri përpjekje për të kaluar në e-learning (të mësuarit në mënyrë elektronike).

BKT punon në mënyrë të vazhdueshme për t'u siguruar se punonjësit janë të kënaqur me punën që bëjnë dhe për të forcuar besnikërinë e tyre ndaj Bankës. Një sondazh i kryer në vitin 2013 tregoi se niveli i kënaqësisë së punonjësve ishte 98%. Promovimi i menaxherëve të mesme femra vazhdojnë të ruajë ende tendencën: niveli i tyre u rrit nga 48% në vitin 2011, në 50% në vitin 2012, deri në 52% në vitin 2013. Qarkullimi vullnetar i stafit mbeti në nivelin e 5.2% në vitin 2013.

Bashkëpunimi me Fakultetin e Studimeve të Integruara me Praktikën të Universitetit "Aleksandër Moisiu" në Durrës (FASTIP), nxorri të 20 të diplomuarit e brezit të tretë në vitin 2013. Të diplomuarit e filluan karrierën e tyre në BKT. Në këtë program ka ende 51 studentë. Në fund të vitit të gjashtë të programit, numri i përgjithshëm i personave që u bënë pjesë e BKT-së ka arritur në 57, ose në 17.7% e të gjithë personave të marrë në punë në vitin 2013.



Diplomimi i Studentëve të FASTIP-it, Klasa e 2013-it.

Pemët e mbjella
u mundësuan nga



NJË RËNDËSI TË
VEÇANTË PËR
QASJEN E BANKËS
PËR ÇËSHTJET
E LIDHURA ME
QËNDRUESHMËRINË
JANË PËRPJEKJET E
SAJ NË FUSHËN E
PËRGJEGJMËRISË
SOCIALE.

VLERËSIMI PËR AKTIVITETET E VITIT 2013

PËRGJEGJSHMËRIA SOCIALE: QASJE DHE PRAKTIKA

Një rëndësi të veçantë për qasjen e bankës për çështjet e lidhura me qëndrueshmërinë janë përpjekjet e saj në fushën e përgjegjshmërisë sociale. Këto përpjekje mbështeten në katër shtylla kryesore: qeverisje, punësim, mjedis, dhe mirëqenie sociale.

Në vitin 2013 BKT përshpejtoi procesin për adoptimin dhe reflektimin e përgjegjshmërisë sociale të korporatës dhe për botimin e politikave për përgjegjshmërinë sociale të korporatës (CSR) nga Banka.

Fakti që Banka mbajti vlerësimin e JCR Eurasia Rating me notën "AA(Alb)/Merit" për qeverisjen e korporatave për BKT-në në vitin 2013 është provë e angazhimit dhe suksesit të



Prezantimi i rrjetit të përgjegjshmërisë sociale të korporatës në Shqipëri.



Aktiviteti i "Pastrimit të Shqipërisë në një Ditë".



Qendra kulturore turke "Yunus Emre", rindërtimi i këndeve të lojërave për fëmijë.

Bankës në këtë fushë. BKT është institucioni i parë dhe i vetëm në Shqipëri që ka marrë këtë vlerësim.

Brenda kuadrit të përgjegjshmërisë sociale Banka angazhohet në projekte dhe në aktivitete në fusha të ndryshme.

Në vitin 2013 BKT ka sponsorizuar;


- Konferencën Ndërkombëtare për Studimet Europiane, organizuar nga Universiteti Epoka.
- Ceremoninë e diplomimit në FASTIP, të organizuar në Durrës, ku u diplomuan 20 studentë; atyre iu ofrua një kontratë pune në BKT.
- Qendrën kulturore turke Yunus Emre. Nëpërmjet këtij sponsorizimi, BKT i ka forcuar marrëdhëniet e saj me këtë institucion si pjesë e përgjegjshmërisë sociale. Me këtë sponsorizim, BKT dhe Qendra kontribuojnë për përmirësimin e këndeve të lojërave për fëmijët.
- Projektin e filluar nga OJF-ja "Green Line Albania". Aktiviteti "Të Pastrojmë Shqipërinë në një Ditë" pati një ndikim të madh për rritjen e ndërgjegjësimit për rëndësinë e mbajtjes së qytetit të pastër, ndërkohë që u hoqën qindra tonë mbeturina. Në aktivitet mori pjesë një numër rekord prej 147,000 vullnetarësh.
- Ceremoninë e hapjes së Sezonit Turistik në Orikum.
- Pjesëmarrjen e skuadrës kombëtare të tenisit në "Davis Cup", të organizuar në San Marino.
- Ekspozitën "Kohë dhe Vende: Stambolli – Koleksion Arti i Bankës Qendrore të Republikës së Turqisë", organizuar në ambientet e Galerisë Kombëtare të Arteve.

Po ashtu, Banka;

- ka mbështetur Bashkinë e Tiranës brenda kuadrit të Projektit të Qytetit të Gjellbër me kontributin për mbjelljen e pemëve në Rrugën "Dritan Hoxha".
- filloi të ishte e pranishme në median sociale në mënyrë që të forcojë marrëdhëniet e Bankës me masën e synuar dhe për t'u bërë më shumë transparente; numri i ndjekësve të saj arriti numrin e përgjithshëm të ndjekësve të të gjitha bankave, duke i dhënë Bankës lidhshmëri në këtë kategori



Konferenca Ndërkombëtare për Studimet Europiane, organizuar nga Universiteti Epoka.



NË VITIN 2014, BKT
DO TË VIJOJË TË
JETË NOVATORE
DHE TË PREZANTOJË
PRODUKTE TË REJA NË
KREDI, DEPOZITA DHE
PAGESA.

OBJEKTIVAT PËR VITIN 2014

Grupi i Bankingut Tregtar dhe Korporatave

- do të rrisë volumin e kredive me kolateral çekun dhe kreditë AGRO, si dhe do të lëshojë Karta AGRO për agrobiznesin dhe Kartën Prima për të gjithë korporatat dhe klientët tregtarë.
- do të zgjerojë më tej bazën e përdoruesve të biznesit që përdorin shërbimin bankar të internetit dhe do të shtojë produktet me e-Paguaj (pagesë elektronike)
- do të fokusohet në projektet e efikasitetit të energjisë dhe Kreditë e Gjelbra për të shtuar pjesëmarrjen tonë në projekte pro ambientit.
- do të jetë përgjegjëse për aktivizimin e Kompanisë Shqiptare të Leasingut dhe do të sigurojë mundësi blerjesh të kryqëzuara për të gjithë klientët.
- do të vazhdojë të luajë rol të rëndësishëm në financimin publik, duke zbatuar produkte të reja dhe nëpërmjet bashkëpunimit me institucione të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare dhe do të ruajë rolin e partnerit më aktiv në projekte të tilla si projekti italian i SME-ve, Projekti GGF, IPARD dhe Programi i USAID-it për Garantimin e Kredisë.

Grupi i Bankingut Individual

- do të vazhdojë të jetë novator dhe do të prezantojë produkte të reja si kredi, depozita dhe pagesa.
- do të shtrijë zonën e përdorimit të kanaleve të shpërndarjes alternative. Do të ofrojë veçori alternative për ATM-të, POS-et dhe Degën "Internet".
- do të hedhë në treg aplikacione të reja bankare për përdorim në telefonat celularë.
- do të rrisë funksionet e kartave të kreditit.
- do të përmirësojë proceset e punës për kreditë dhe operacionet e degës.
- do të hedhë në treg ofrimin e shumë produkteve për shitje si një produkt i vetëm.

Grupi i Thesarit dhe Institucioneve Financiare

- do të krijojë infrastrukturën për ofrimin e transaksioneve repo për klientët individë.
- do të koordinojë përpjekjet për të marrë një kësht prej 5 milionë eurosh të nënkredisë për projektin GGF.
- do të eksplorojë bankat më të njohura në Afrikë dhe në Azinë Qendrore me synimin e krijimit të marrëdhënieve dhe të bërjes me to të investimeve fitimprurëse afatshkurtra.
- do të përpiqet të vërë në punë një projekt menaxhimi tërësisht automatik Front Office-Back Office Management dhe të fillojë zbatimin e projektit.

- do të planifikojë të organizojë në Shqipëri një Konferencë Ndërkombëtare për Bankat, me synim mbledhjen së bashku të shumë bankave nga gjeografi të ndryshme.
- do të vlerësojë mundësitë për krijimin e zyrave të përfaqësimit në Turqi, ose në Rajonin e Gjirit, dhe blerjen e një banke në rajonin tonë.

Departamenti i Burimeve Njerëzore

- do të punojë për të qenë proaktiv dhe i dobishëm për të ruajtur avantazhin konkurrues të Bankës nëpërmjet ndërtimit të një kulture të një kompanie të drejtuar nga rezultatet dhe që vepron si një partner biznesi.
- do të ofrojë zgjidhje duke ofruar një kulturë të qëndrueshmë në korporatë duke ofruar trajnime dhe aktivitete zhvilluese, praninë e ndryshimit konstant, rekrutimin, zhvillimin, motivimin dhe mbajtjen e stafit që arrin rezultatet më të larta.
- Programet e lidhshme dhe të zhvillimit të talenteve do të kultivojnë në mënyrë të brendshme talentet e Bankës për planifikimin e vijueshëm dhe për rritjen e qëndrueshmë të bankave.
- Menaxhimi i Burimeve Njerëzore, Novacionet dhe Sistemet Informuese të Burimeve Njerëzore do të përqendrohen tek arritja e performancës së qëndrueshme të Bankës për përdorimin e Statistikave të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore për të pasur ndikimin maksimal mbi kapitalin njerëzor të Bankës.

Grupi i Menaxhimit të Riskut

- do të vazhdojë të ketë jo vetëm nivelin më të ulët të kredive me probleme në grupin e bankave të të njëjtit nivel, por do të vazhdojë ta ulë këtë përqindje në nivelin 7.5%.

Grupi i Financës dhe i

- do t'i japë përparësi zbatimit të moduleve të reja të Flexcube-it për garancitë, kreditë dhe LC-të .
- do të përfundojë transferimin gradual të dhomës së serverit dhe rivendosjen e Qendrës për Rigjurmimin e të Dhënave në Rast Fatkeqësie.
- do të vazhdojë të ofrojë raportim në kohë dhe me cilësi për aksionerët, autoritetet dhe strukturat drejtuese, duke zbatuar ndryshimet e duhura dhe thelbësore për raportin rregullator.
- do të krijojë një paketë plotësisht automatike për Komitetin ALCO në koordinim me të gjithë anëtarët e ALCO-s.

Banka Kombëtare Tregtare Sh.a.

Shënime mbi Pasqyrat Financiare të Konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013
(shprehur në USD, nëse nuk është shënuar ndryshe)

Përmbajtja

	Faqe
PASQYRAT FINANCIARE TË KONSOLIDUARA:	
PASQYRA E KONSOLIDUAR E POZICIONIT FINANCIAR	1
PASQYRA E KONSOLIDUAR E FITIMIT OSE HUMBJES DHE TË ARDHURAVE TË TJERA PËRMBLEDHËSE	2
PASQYRA E KONSOLIDUAR E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	3-4
PASQYRA E KONSOLIDUAR E RRJEDHËS SË PARASË	5
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE TË KONSOLIDUARA	6 - 61

Banka Kombëtare Tregtare Sh.a.

Raporti i Audituesve të Pavarur

Deloitte.

Deloitte Albania sh.p.k
Rr. Elbasanit,
Pallati poshte Fakulteti Gjeologji-
Miniera
Tirana, Albania
Tel: +355 4 45 17 920
Fax: +355 4 45 17 990
www.deloitte.al

Place of registration: Tirana Court,
Decision 16016
VAT (NUIIS) No: J62329003N

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Aksionarit dhe Drejtimit të Banka Kombëtare Tregtare Sh.a:

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të konsoliduara të bashkëngjitura të Banka Kombëtare Tregtare sh.a. të cilat përmbajnë pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar më 31 dhjetor 2013, pasqyrën e konsoliduar të fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse, pasqyrën e konsoliduar të ndryshimeve të kapitalit, pasqyrën e konsoliduar të rrjedhës së parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, si dhe një përmbledhje e parimeve bazë kontabël dhe informacione të tjera shpjeguese.

Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare të konsoliduara

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar dhe për kontrollin e brendshëm i cili, në masën që përcaktohet nga Drejtimi, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara pa pasaktësi materiale si rezultat i mashtrimeve apo gabimeve.

Përgjegjësia e Auditorit

Përgjegjësia jonë është që, bazuar në auditimin tonë, të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare të konsoliduara. Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde, kërkojnë që ne të përmbushim kërkesat e etikës dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin, me qëllim që të përftojme siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare të konsoliduara nuk kanë pasaktësi materiale.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për sigurimin e të dhënave të auditimit, për vlerat dhe deklaratimet në pasqyrat financiare të konsoliduara. Procedurat e përzgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, përfshi këtu dhe vlerësimin e rreziqeve të ekzistencës së gabimeve në pasqyrat financiare të konsoliduara, qofshin këto si rezultat i mashtrimeve apo i gabimeve. Gjatë vlerësimit të rreziqeve, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare të konsoliduara, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Një auditim përfshin gjithashtu vlerësimin për përshtatshmërinë e parimeve kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kryesore të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare të konsoliduara.

Ne besojmë se të dhënat e auditimit që kemi marrë ofrojnë baza të mjaftueshme dhe të përshtatshme për dhënien e opinionit të auditimit.

Opinionit

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare të konsoliduara paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Banka Kombëtare Tregtare sh.a. më 31 dhjetor 2013, si dhe rezultatit e operacioneve dhe rrjedhën e parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Deloitte refers to one or more of Deloitte Touche Tohmatsu Limited, a UK private company limited by guarantee, and its network of member firms, each of which is a legally separate and independent entity. Please see <http://www.deloitte.com/al/about> for a detailed description of the legal structure of Deloitte Touche Tohmatsu Limited and its member firms.

Member of Deloitte Touche Tohmatsu Limited

Çështje të tjera

Pasqyrat financiare të konsoliduara të Banka Kombëtare Tregtare Sh.a. për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012, janë audituar nga një auditor tjetër, i cili ka shprehur një opinion të pamodifikuar për këto pasqyra financiare të konsoliduara më 26 shkurt 2013.


24 shkurt 2014
Tiranë, Shqipëri


Elvis Ziu
Partner Angazhimi

Banka Kombëtare Tregtare Sh.a.

Pasqyra e konsoliduar e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2013
(shprehur në USD)

Aktivet	Shënime	31 dhjetor 2013	31 dhjetor 2012
Arka dhe llogari me Bankën Qendrore	7	237,473,002	231,341,516
Depozita dhe llogari me bankat	8	201,279,874	149,439,990
Bono thesari	9	236,724,368	266,464,865
Investime të vlefshme për shitje	10	697,179,575	369,864,054
Investime të mbajtura deri në maturim	11	217,755,420	221,912,787
Hua për bankat	12	121,650,866	192,135,941
Hua për klientët	13	886,202,417	854,185,956
Investime në filiale	14	1,651,128	-
Aktive të qëndrueshme të trupëzuara	15	27,942,467	28,168,784
Aktive të qëndrueshme të patrupëzuara	16	1,235,689	1,514,911
Aktive të tjera	17	46,647,434	22,285,162
Totali i aktiveve		2,675,742,240	2,337,313,966
Detyrimet dhe kapitali aksionar			
Detyrimet			
Detyrime ndaj klientëve	18	2,154,265,396	1,884,887,955
Detyrime ndaj bankave dhe institucioneve financiare	19	278,355,823	239,104,842
Detyrime ndaj palëve të treta	20	1,738,013	2,249,325
Detyrime tatimore të shtyra	21	3,264,859	1,978,653
Detyrime të tjera	22	9,355,434	11,594,079
Borxhi i varur	23	13,796,864	13,195,323
Totali i detyrimeve		2,460,776,389	2,153,010,177
Kapitali aksionar			
Kapitali aksionar i paguar	24	138,965,905	100,000,000
Rezerva ligjore	24	-	3,410,723
Rezerva e rivlerësimit	24	1,140,491	394,191
Rezerva e vlerës së drejtë	24	(3,196,237)	6,845,965
Fitimi i pashpërndarë	24	78,055,692	73,652,910
Totali i kapitalit aksionar		214,965,851	184,303,789
Totali i detyrimeve dhe kapitalit aksionar		2,675,742,240	2,337,313,966

Pasqyra e konsoliduar e pozicionit financiar duhet lexuar së bashku me shënimet mbi pasqyrat financiare të konsoliduara nga faqja 6 deri në faqen 62, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara.

Pasqyrat financiare të konsoliduara u autorizuan nga Këshilli Drejtues më 28 janar 2014 dhe u nënshkruan në emër të tij nga:



Seyhan Pencabligil
Drejtor i Përgjithshëm dhe
Anëtar i Këshillit Drejtues



Skender Emini
Drejtor i Grupit të Financës
dhe TI

Banka Kombëtare Tregtare Sh.a.

Pasqyra e konsoliduar e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013

(shprehur në USD)

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2013	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2012
Interesi			
Të ardhura nga interesi	25	153,584,608	141,014,694
Shpenzime interesi	26	(75,024,078)	(69,640,869)
Të ardhura nga interesi, neto		78,560,530	71,373,825
Të ardhura të tjera, neto nga veprimtaria bankare			
Tarifa dhe komisione, neto	27	9,557,408	8,658,204
Humbja neto nga rivlerësimi i valutave	28	(4,035,425)	(516,931)
(Humbja)/fitimi neto nga këmbimet valutore		(1,623,197)	13,542
Të ardhura/(shpenzime) të tjera, neto	29	10,743,743	(267,218)
Totali i të ardhurave të tjera neto nga veprimtaria bankare		14,642,529	7,887,597
Shpenzime operative			
Shpenzime personeli	30	(17,105,138)	(15,463,046)
Shpenzime administrative	31	(20,974,604)	(20,050,040)
Zhvlerësimi dhe amortizimi	15,16,17	(5,090,334)	(4,898,236)
Totali i shpenzimeve operative		(43,170,076)	(40,411,322)
Zhvlerësimi i huave	13	(6,199,500)	(4,191,264)
Fitimi para tatimit		43,833,483	34,658,836
Tatimi mbi fitimin	32	(4,530,730)	(3,763,562)
Fitimi neto i vitit		39,302,753	30,895,274
Diferenca konvertimi të monedhave të huaja		746,300	3,142,486
Ndryshimet neto në rezervën e vlerës së tregut		(10,042,202)	14,068,130
(Shpenzime)/të ardhura të tjera përmbledhëse për vitin, neto pas tatimit		(9,295,902)	17,210,616
Totali i të ardhurave përmbledhëse për vitin		30,006,851	48,105,890

Pasqyra e konsoliduar e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse duhet lexuar së bashku me shënimet mbi pasqyrat financiare të konsoliduara nga faqja 6 deri në faqen 61, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara.

Banka Kombëtare Tregtare Sh.a.

Pasqyra e konsoliduar e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013

(shprehur në USD)

	Kapitali aksionar i paguar	Rezerva Ligjore	Rezerva e rivlerësimit	Rezerva e vlerës së tregut	Fitimi i pashpërndarë	Totali
Gjendja më 1 janar 2012	100,000,000	-	(2,748,295)	(7,222,165)	48,134,973	138,164,513
Veprimet me pronarët të regjistruara direkt në kapital						
Totali i kontributeve nga pronarët dhe shpërndarjeve për pronarët						
Krijimi Rezerves Ligjore	-	3,410,723	-	-	(3,410,723)	-
Kthimi i diferencave të rivlerësimit të vitit 2011	-	-	-	-	(2,748,295)	(2,748,295)
Rregullimi i fitimit të pashpërndarë me kursin e fund vitit 2012	-	-	-	-	781,681	781,681
<i>Totali i kontributeve nga pronarët dhe shpërndarjeve për pronarët</i>	-	3,410,723	-	-	(5,377,337)	(1,966,614)
Totali i të ardhurave përmblendhëse për vitin						
Fitimi neto i vitit	-	-	-	-	30,895,274	30,895,274
Të ardhura të tjera përmblendhëse, neto pas tatimit						
Ndryshimet neto në rezervën e vlerës së tregut	-	-	-	14,068,130	-	14,068,130
Diferenca konvertimi të monedhave të huaja	-	-	3,142,486	-	-	3,142,486
Totali i të ardhurave të tjera përmblendhëse	-	-	3,142,486	14,068,130	-	17,210,616
<i>Totali i të ardhurave përmblendhëse për vitin</i>	-	-	3,142,486	14,068,130	30,895,274	48,105,890
Gjendja më 31 dhjetor 2012	100,000,000	3,410,723	394,191	6,845,965	73,652,910	184,303,789

Pasqyra e konsoliduar e ndryshimeve në kapital duhet lexuar së bashku me shënimet mbi pasqyrat financiare të konsoliduara nga faqja 6 deri në faqen 62, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara.

Banka Kombëtare Tregtare Sh.a.

Pasqyra e konsoliduar e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013
(shprehur në USD)

	Kapitali aksionar i paguar	Rezerva Ligjore	Rezerva e rivlerësimit	Rezerva e vlerës së tregut	Fitimi i pashpërndarë	Totale
Gjendja më 1 janar 2013	100,000,000	3,410,723	394,191	6,845,965	73,652,910	184,303,789
Veprimet me pronarët të regjistruara direkt në kapital						
Totale i kontributeve nga pronarët dhe shpërndarjeve për pronarët						
Rritja e kapitalit aksionar	38,965,905	(3,282,146)	-	-	(35,683,759)	-
Rregullimi i diferencave të rivlerësimit të rezervës ligjore	-	(128,577)	-	-	128,577	-
Kthimi i diferencave të rivlerësimit të vitit 2012	-	-	-	-	394,191	394,191
Rregullimi i fitimit të pashpërndarë me kursin e fund vitit 2013	-	-	-	-	261,020	261,020
<i>Totale i kontributeve nga pronarët dhe shpërndarjeve për pronarët</i>	<i>38,965,905</i>	<i>(3,410,723)</i>	<i>-</i>	<i>-</i>	<i>(34,899,971)</i>	<i>655,211</i>
Totali i të ardhurave/(humbjes) përmblendhëse për vitin						
Fitimi neto i vitit	-	-	-	-	39,302,753	39,302,753
Të ardhura/(humbje) të tjera përmblendhëse, neto pas tatimit						
Ndryshimet neto në rezervën e vlerës së tregut	-	-	-	(10,042,202)	-	(10,042,202)
Diferenca konvertimi të monedhave të huaja	-	-	746,300	-	-	746,300
Totali i të ardhurave/(humbjeve) të tjera përmblendhëse	-	-	746,300	(10,042,202)	-	(9,295,902)
Totali i të ardhurave (humbjes) përmblendhëse për vitin	-	-	746,300	(10,042,202)	39,302,753	30,006,851
Gjendja më 31 dhjetor 2013	138,965,905	-	1,140,491	(3,196,237)	78,055,692	214,965,851

Pasqyra e konsoliduar e ndryshimeve në kapital duhet lexuar së bashku me shënimet mbi pasqyrat financiare të konsoliduara nga faqja 6 deri në faqen 62, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara.

Banka Kombëtare Tregtare Sh.a.

Pasqyra e konsoliduar e rrjedhës së parasë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013

(shprehur në USD)

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2013	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2012
Rrjedha e parave nga aktivitetet operacionale:			
Fitimi para tatimit		43,833,483	34,658,836
Rregullime për të barazuar ndryshimet në aktivet neto me rrjedhën neto të parave nga aktivitetet operacionale:			
Shpenzime interesi	26	75,024,078	69,640,869
Të ardhura nga interesi	25	(153,584,608)	(141,014,694)
Amortizimi dhe zhvlerësimi	15,16,17	5,090,334	4,898,236
Fitimi nga shitja e aktiveve të trupëzuara		(25,936)	(59,208)
Fitimi nga shitja e bonove të thesarit		(168,018)	(353,888)
Fitimi nga shitja e aktiveve të fituara me proces ligjor		(95,933)	(111,697)
Fitimi nga arkëtimi i kredive të humbura		(40,425)	(3,853)
Nxjerrje jashtë përdorimit e aktiveve të trupëzuara		2,594	25,622
Humbje nga kreditë e humbura të pakthyeshme		24,068	129,054
Provizione për debitorë të tjerë		332,379	524,232
Lëvizje në rezervën e vlerës së drejtë		(9,939,563)	13,877,954
Provizione për humbjet nga huatë	13	6,199,500	4,191,264
Rrjedha e parave nga fitimet operacionale para ndryshimeve në aktive dhe detyrime operacionale		(33,348,047)	(13,597,273)
(Rritja)/ Pakësimi i aktiveve operacionale:			
Llogaritë e kufizuara me bankën qendrore		(514,567)	(32,955,716)
Depozita dhe llogari me bankat		(10,704,937)	9,697,384
Hua për bankat		74,438,070	(89,474,935)
Hua për klientët		(3,875,408)	(66,869,790)
Aktive të tjera		(21,715,769)	1,296,669
		37,627,390	(178,306,388)
Rritja/ (Pakësimi) i detyrimeve operacionale:			
Detyrime ndaj klientëve		188,495,231	267,682,837
Detyrime ndaj palëve të treta		(577,864)	(800,134)
Detyrime të tjera		(2,146,658)	2,932,211
Borxhi varur		57,733	12,903,494
		185,828,442	282,718,408
Interesi i paguar		(75,022,796)	(65,007,626)
Interesi i arkëtuar		149,653,423	133,849,787
Tatimi fitimi i paguar		(4,980,028)	(4,683,274)
Rrjedhja neto te parasë nga aktivitetet operacionale		259,758,384	154,973,634
Rrjedhja e parave nga aktivitetet investuese			
Blerje e investimeve		(283,360,513)	(145,449,955)
Blerje e bonove të thesarit		(8,726,332)	(132,073,008)
Investime në filiale		(1,591,746)	-
Blerje e aktiveve të trupëzuara		(3,534,302)	(16,310,626)
Hyrje nga shitja e aktiveve të trupëzuara		75,601	160,866
Hyrje nga shitja e bonove të thesarit		45,312,300	82,631,851
Paraja neto e përdorur në aktivitetet investuese		(251,824,991)	(211,040,872)
Rrjedhja e parave nga aktivitetet financuese			
Hyrje nga huatë afatshkurtra		28,848,590	103,896,222
Neto e gjeneruar nga aktivitetet financuese		28,848,590	103,896,222
Rritja neto e parasë dhe ekuivalentëve të saj			
Diferencat në kursin e këmbimit		36,781,982	47,828,984
Paraja dhe ekuivalentët e saj në fillim të vitit	7	199,640,486	147,124,564
Paraja dhe ekuivalentët e saj në fund të vitit	7	238,615,381	199,640,486

Pasqyra e konsoliduar e rrjedhës së parasë duhet lexuar së bashku me shënimet mbi pasqyrat financiare të konsoliduara nga faqja 6 deri në faqen 62, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara.

Banka Kombëtare Tregtare Sh.a.

Shënime mbi Pasqyrat Financiare të Konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013
(shprehur në USD, nëse nuk është shënuar ndryshe)

1. Të përgjithshme

Banka Kombëtare Tregtare Sh.a. është një bankë tregtare që ofron një gamë të gjerë me shërbime të plota. Pasqyrat e konsoliduara financiare përfshijnë Bankën dhe degën e saj në Kosovë (referuar së bashku në vazhdim si "Banka", ose "BKT").

Banka ofron shërbime bankare për ndërmarrje shtetërore e private dhe individë. Burimi kryesor i fondeve për Bankën janë depozitat, të cilat Banka i pranon në forma të ndryshme duke përfshirë llogaritë rrjedhëse, depozita me dhe pa afat, si në Lek ashtu edhe në valutë. BKT ofron: një shumëllojshmëri të kredive për biznese dhe individë, karta krediti dhe debiti në përputhje me standartin EMV, bankomate, bankingu në internet, bankingu në telefon celular, shërbime bankingu on-line, shërbim të kualifikuar të bankingut ndërkombëtar dhe produkte të ndryshme thesari. Gjithashtu, ajo investon në letra me vlerë dhe merr pjesë aktivisht në tregun ndërbankar lokal dhe ndërkombëtar.

BKT është krijuar në formën aktuale ligjore më 30 dhjetor 1992, megjithëse dega e saj e parë është hapur më 30 nëntor 1925. BKT është subjekt i Ligjit nr. 8269 "Mbi Bankën e Shqipërisë" me datë dhjetor 1997 dhe i Ligjit nr. 9662 "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë", të datës 18 dhjetor 2006.

Në bazë të Vendimit të Aksionarëve të marrë në datën 28 mars 2012, Banka krijoi rezervën ligjore prej 358,706 mijë Lek (ekuivalente e 3,410,723 USD), duke përdorur një pjesë të fitimit të pashpërndarë nga viti i kaluar.

Në bazë të Vendimit të Aksionarëve të marrë në datën 27 mars 2013, Banka rriti kapitalin e saj të paguar me shumën 4,258,584 mijë Lek (ekuivalente e 38,965,904.9 USD), duke përdorur rezervën ligjore prej 358,706 mijë Lek (ekuivalente e 3,282,145.8 USD) si edhe një pjesë të fitimit të saj të pashpërndarë prej 3,899,878 mijë Lek (ekuivalente e 35,683,759.1 USD). Rritja e kapitalit u konvertua në USD me kursin e këmbimit të publikuar nga Banka e Shqipërisë për datën 27 mars 2013 (109.29 Lek për USD).

Në vijim të kësaj rritje, struktura aksionare mbeti e njëjtë, me vlerë nominale të aksioneve 12.35 USD, ndërsa numri i aksioneve u rrit me 3,155,134 aksione. Struktura aksionare më datë 31 dhjetor 2013 dhe 31 dhjetor 2012 paraqitet si më poshtë:

	31 dhjetor 2013			31 dhjetor 2012		
	Nr. i aksioneve	Totali USD	%	Nr. i aksioneve	Totali USD	%
Calik Finansal Hizmetler A.S.	11,252,300	138,965,905	100	8,097,166	100,000,000.10	100

Drejtoria e Përgjithshme e BKT ndodhet në Tiranë. Aktualisht në Shqipëri, Banka zotëron një rrjet prej 58 degësh dhe 2 agjencish doganore. Njëzet e dy prej degëve ndodhen në Tiranë dhe të tjerat në Durrës, Elbasan, Vlorë, Shkodër, Fier, Pogradec, Korçë, Bilisht, Gjirokastrë, Delvinë, Sarandë, Orikum, Berat, Kuçovë, Lushnje, Librazhd, Peqin, Rrogozhinë, Shkozë, Kavajë, Vore, Kamzë, Fushe Krujë, Laç, Lezhë, Rrëshen, Kukës, Peshkopi, Bushat dhe Koplik, të ndjekura nga agjencitë doganore në Portin e Durrësit dhe Aeroportin e Rinasit. Gjatë vitit 2013, Banka hapi një degë të re në Tiranë.

Rrjeti në Kosovë përfshin 24 njësi. Pesë njësi ndodhen në Prishtinë, ndërsa të tjerat janë të vendosura në Prizren, Pejë, Gjilan, Ferizaj, Mitrovicë, Gjakovë, Vushtrri, Fushë Kosovë, Podujevë, Drenas, Rahovec, Viti dhe Lipjan, Hani i Elezit, Dheu i Bardhe, Aeroporti i Prishtinës dhe Skenderaj.

Banka kishte 1,161 punonjës (2012: 1,135) në datën 31 dhjetor 2013, nga të cilët 274 (2012: 285) i përkasin Degës së Kosovës.

Banka Kombëtare Tregtare Sh.a.

Shënime mbi Pasqyrat Financiare të Konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013
(shprehur në USD, nëse nuk është shënuar ndryshe)

2. Bazat e përgatitjes

(a) Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare të konsoliduara janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ('SNRF').

(b) Baza e matjes

Pasqyrat financiare të konsoliduara janë përgatitur bazuar në kosto historike, përveç instrumenteve financiare të gatshme për shitje, të cilët janë matur me vlerën e drejtë, investimeve në pronë, të cilat janë matur me vlerën e drejtë dhe aktiveve afatgjata të mbajtura për shitje, të cilat janë matur me vlerën më të ulët mes vlerës së mbetur dhe vlerës së drejtë, duke i zbritur kostot e shitjes.

Për qëllime të raportimit financiar, përllogaritjet e vlerës së drejtë janë grupuar në Nivelet 1, 2 ose 3, bazuar në nivelin e verifikueshmërisë të elementëve të llogaritjes së vlerës së drejtë dhe në rëndësinë e këtyre elementëve në llogaritjen e vlerës së drejtë në tërësi, siç pershkruhet më poshtë:

- Informacionet e përdorura për përllogaritje në Nivelin 1 janë çmimet e tregut të listuara (të pa rregulluara), në një treg aktiv për aktive ose detyrime të njëjta, në të cilat entiteti ka akses në datën e llogaritjes së vlerës së drejtë;
- Informacionet e përdorura për përllogaritje në Nivelin 2 janë të dhëna të ndryshme nga çmimet e listuara në treg të përfshira në Nivelin 1, të cilat janë të verifikueshme për aktivin ose pasivin, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose indirekte; dhe
- Informacionet e përdorura për përllogaritje në Nivelin 3 janë të dhëna jo të verifikueshme për aktivin ose pasivin.

(c) Monedha funksionale dhe raportuese

Pasqyrat financiare të konsoliduara paraqiten në USD. Monedha funksionale e Bankës është Lek.

Banka ka zgjedhur t'i prezantojë pasqyrat financiare në USD, meqenëse kapitali i saj është i zotëruar plotësisht nga investitorë ndërkombëtarë, të cilët kanë kontribuar kapitalin fillestar në USD dhe e vëzhgojnë performancën e investimit në USD.

(d) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare të konsoliduara kërkon që drejtimi të kryejë gjykime, vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të jenë të ndryshme nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe supozimet bazë rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimet rishikohen si dhe në periudhat e ardhme nëse ato ndikohen.

Informacioni mbi elementët e rëndësishëm të pasigurive të vlerësimit dhe mbi gjykimet kritike në përdorimin e politikave kontabël me efekt të rëndësishëm në vlerat kontabël në pasqyrat financiare të konsoliduara, jepet në shënimet 4 dhe 5.

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël

Politikat kontabël të paraqitura më poshtë janë zbatuar në mënyrë të qëndrueshme në të gjitha periudhat e prezantuara në këto pasqyra financiare të konsoliduara dhe në mënyrë të njëjtë nga njësitë e Bankës.

(a) Baza e konsolidimit

(i) Filialet

Filialet janë njësi (degë) të kontrolluara nga Banka. Kontrolli ekziston kur Banka ka fuqi mbi një njësi ekonomike, është e ekspozuar, ose ka të drejta mbi përfitimet e ndryshueshme nga përfshirja e saj tek njësi, dhe ka aftësinë për të përdorur fuqinë e saj për të ndikuar në përfitimet e njësisë. Banka rivlerëson nëse ka apo jo kontroll mbi një filial, nëse faktet dhe rrethanat tregojnë se ka ndryshime të një ose më shumë nga tre elemente të kontrollit të listuara më lart.

Banka Kombëtare Tregtare Sh.a.

Shënime mbi Pasqyrat Financiare të Konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013
(shprehur në USD, nëse nuk është shënuar ndryshe)

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(a) Baza e konsolidimit (vazhdim)

(i) Filialet (vazhdim)

Konsolidimi i një filiali fillon nga momenti kur Banka merr kontrollin mbi filialin dhe ndalon kur Banka humb kontrollin e filialit. Të ardhurat dhe shpenzimet e një filiali, të blerë apo shitur gjatë vitit njihen në pasqyrën e konsoliduar të fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse nga data kur Banka mer kontrollin deri në datën kur Banka humbet kontrollin mbi njësinë.

Pasqyrat financiare të konsoliduara janë përgatitur duke përdorur politika kontabël të njëjta për transaksione të njëjta dhe ngjarje të tjera në rrethana të ngjashme.

Në datën 3 shtator 2007, BKT hapi degën e saj të parë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Zyra Administrative e kësaj dege u hap në qytetin e Prishtinës, Kosovë. Monedha funksionale e degës është EURO. Efekti i kthimit të veprimeve në monedhë të huaj në monedhën funksionale të Bankës shpjegohet në Shënimin 3.(b).(ii) më poshtë.

(ii) Veprimet e eliminuara gjatë konsolidimit

Tepricat brenda grupit, dhe të ardhurat dhe shpenzimet që vijnë nga veprimet brenda grupit (me përjashtim të fitimeve ose humbjeve nga veprimet në monedhë të huaj), janë eliminuar gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare të konsoliduara. Humbjet e përealizuara janë eliminuar në të njëjtën mënyrë si fitimet e përealizuara, por deri në masën që nuk ka evidencë për rënie të vlerës.

(b) Monedha të huaja

(i) Veprimet në monedhë të huaja

Veprimet në monedhë të huaj janë kthyer në monedhën funksionale respektive me kursin e këmbimit të datës kur është kryer veprimi. Aktivitet dhe pasivitet monetare, të shprehura në monedhë të huaj në datën e raportimit janë kthyer në monedhën funksionale, me kursin e këmbimit të asaj date. Fitimi apo humbja nga kursi i këmbimit i instrumenteve monetare, është ndryshimi midis kostos së amortizuar në monedhë funksionale në fillim të periudhës, e regulluar kjo për interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës, dhe kostos së amortizuar në monedhë të huaj të kthyer në monedhën funksionale, me kursin e këmbimit në datën e raportimit. Aktivitet dhe detyrimet jo monetare në monedhë të huaj, që maten me vlerë të drejtë, kthehen në monedhë funksionale me kursin e këmbimit në datën kur është përcaktuar vlera e drejtë. Ndryshimet që rrjedhin nga ndryshimi i kursit të këmbimit të valutave janë njohur në të ardhura ose shpenzime

Aktivitet dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj, të cilat shprehen me kosto historike, këmben me kursin e datës së veprimit, me përjashtim të kapitalit aksionar të paguar, i cili është emetuar dhe mbahet në USD sipas legjislacionit në Shqipëri, dhe në veçanti në përputhje me Ligjin nr. 8634, datë 6 korrik 2000, sipas marrëveshjes ndërmjet aksionerëve të Bankës dhe Republikës së Shqipërisë mbi privatizimin e Bankës.

Për më tepër, Rregullorja e Operacioneve të Bankës kërkon që kapitali aksionar i paguar të mbrohet nga aktivitet në USD, dhe prandaj është i trajtuar si një zë monetar, me diferencën e rivlerësimit të kaluar në fitim/humbje së bashku me diferencën e rivlerësimit të aktivitet korrespondues në USD, të cilat kompensojnë njëra-tjetrën në një mënyrë të natyrshme.

(ii) Operacionet e huaja

Aktivitet dhe detyrimet janë të kthyer në Lek me kursin e këmbimit në datën e raportimit. Të ardhurat dhe shpenzimet janë kthyer në Lek me kursin e datës së veprimit. Diferencat e kursit të këmbimit që lidhen me kthimin e operacioneve të huaja, janë njohur direkt në të ardhura të tjera përmbledhëse. Këto diferenca janë njohur në rezervën e rivlerësimit.

Banka Kombëtare Tregtare Sh.a.

Shënime mbi Pasqyrat Financiare të Konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013
(shprehur në USD, nëse nuk është shënuar ndryshe)

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(b) Monedha të huaja

(iii) Përktimi i pasqyrave financiare nga monedha funksionale në monedhën e prezantimit

Përktimi i pasqyrave financiare nga monedha funksionale në monedhën e prezantimit është si më poshtë:

- aktivet dhe detyrimet në datën e raportimit (duke përfshirë shifrat krahasuese) janë kthyer me kursin e mbylljes në datën e raportimit, i cili është kursi i Bankës së Shqipërisë 1 USD = 101.86 Lek (2012: 105.85).
- të ardhurat dhe shpenzimet (duke përfshirë shifrat krahasuese) janë kthyer me kurset e datës së veprimeve.
- zërat e kapitalit, përveç fitimit neto, kapitalit të paguar dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse janë kthyer me kursin e mbylljes në datën e raportimit.
- kapitali aksionar i paguar është kthyer siç është përshkruar në paragrafin 3(b), (i) më sipër; dhe
- të gjitha diferencat prej kursit të këmbimit janë njohur si një përbërës i veçantë i kapitalit në llogarinë e 'Rezervës së rivlerësimit'.

(iv) Veprimet "spot" në monedhë të huaj

Banka, gjatë veprimtarisë normale të biznesit ndërmerr veprime në monedhë të huaj "spot", për të cilat data e kryerjes është 1 ose 2 ditë pas datës së tregtimit. Këto veprime janë regjistruar në pasqyrat financiare në datën e kryerjes. Diferencat në monedhë të huaj njihen në fitim/humbje në datën e shlyerjes.

(c) Interesi

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesat njihen në fitim ose humbje duke përdorur metodën e interesit efektiv. Norma e interesit efektiv është norma që skanton saktësisht pagesat dhe arkëtimet e pritshme në të ardhmen gjatë jetëgjatësisë së parashikuar të aktivitetit ose detyrimit financiar (ose një periudhë më e shkurtër, kur duhet) deri në vlerën kontabël të aktivitetit ose detyrimit financiar. Kur llogarit normën e interesit efektiv, Banka vlerëson flukset e ardhshme monetare duke marrë në konsideratë të gjitha kushtet kontraktuale të instrumentit financiar, por jo humbjet e ardhshme.

Llogaritja e normës së interesit efektiv përfshin të gjitha komisionet dhe shumat e paguara apo të arkëtuara, që janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit. Kostot e veprimeve përfshijnë kosto shtesë të lidhura drejtpërdrejt me blerjen apo emetimin e një aktivi apo detyrimi financiar.

(d) Tarifa dhe komisione

Të ardhurat dhe shpenzimet nga tarifat dhe komisionet, të cilat janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit për një aktiv ose detyrim financiar, përfshihen në matjen e normës efektive të interesit. Të ardhurat e tjera nga komisionet dhe tarifat njihen në momentin e kryerjes së shërbimeve të lidhura me to.

Shpenzime të tjera për komisione dhe tarifa lidhen kryesisht me tarifa veprimesh ose shërbimesh, të cilat shpenzohen në momentin që shërbimet përfitohen.

(e) Pagesat e qirasë

Pagesat e kryera për qiranë operative janë njohur në fitim ose humbje në mënyre lineare gjatë periudhës së qirasë. Zbritjet nxitëse njihen si pjesë përbërëse e shpenzimit total të qirasë përgjatë jetës së qirasë.

Banka Kombëtare Tregtare Sh.a.

Shënime mbi Pasqyrat Financiare të Konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013
(shprehur në USD, nëse nuk është shënuar ndryshe)

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(f) Tatim fitimi

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës aktuale dhe tatimin e shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në fitim ose humbje, përveç pjesës që lidhet me zëra të njohur direkt në kapital ose të ardhura të tjera përmbledhëse. Tatimi aktual është tatimi që pritet të paguhet ose të arkëtohet mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke përdorur normën tatimore në fuqi ose që hyn në fuqi në datën e raportimit, dhe çdo sistemim të tatimit të pagueshëm për vitet e mëparshme.

Tatimi i shtyrë është njohur për diferencat e përkohshme ndërmjet vlerës kontabël neto të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi financiar dhe shumave të përdorura për qëllime tatimore. Tatimi i shtyrë nuk njihet për diferencat e mëposhtme: njohjen fillestare të emrit të mirë, njohjen fillestare të aktiveve apo detyrimeve në një veprim që nuk është kombinim biznesi dhe që nuk ndikon as fitim/humbjen kontabël dhe as atë të tatueshëm, dhe diferenca lidhur me investimet në filiale në masën që ato mund të mos i kthejnë këto në të ardhmen. Tatimi i shtyrë është matur duke përdorur normën tatimore që pritet të aplikohet ndaj diferencave të përkohshme kur ato të kthehen, bazuar në ligjet në fuqi ose që hyjnë në fuqi në datën e raportimit.

Në llogaritjen e tatimit aktual dhe të shtyrë Banka merr në konsideratë ndikimin e disa pozicioneve të pasigurta, nëse duhet të llogarisë taksa dhe interesa shtesë. Banka beson që për llogaritjet e saj për detyrimet tatimore janë të përshtatshme për të gjitha vitet tatimore të hapura bazuar në vlerësimin e saj të shumë faktorëve, duke përfshirë këtu interpretimet e ligjeve tatimore dhe eksperiencës së mëparshme. Ky vlerësim mbështetet në çmuarjen dhe supozimet dhe mund të përfshijë një sërë gjykimesh mbi ngjarje të ardhshme. Informacione të reja që mund të bëhen të disponueshme mund të shkaktojnë që Banka të ndryshojë gjykimin e saj mbi përshtatshmërinë e detyrimeve tatimore ekzistuese; ndryshime të tilla në detyrimet tatimore do të ndikojnë shpenzimin tatimor të periudhës së kryerjes së këtyre përcaktimeve.

Aktivi tatimor i shtyrë njihet për aq sa është e mundur që do të realizohet fitim i ardhshëm i tatueshëm, në mënyrë që të mund të përdoret kundrejt tij. Aktivi tatimor i shtyrë rishikohet në çdo datë raportimi dhe zvogëlohet nëse nuk është e mundur të realizohet përfitim fiskal. Të ardhura të tjera të tatueshme nga shpërndarja e dividendëve, njihen në të njëjtën kohë kur njihet edhe detyrimi për të paguar dividendin.

(g) Aktivet dhe detyrimet financiare

(i) Njohja

Banka fillimisht njeh huatë, depozitat, letrat me vlerë të borxhit të emtuar dhe detyrimet e varura në datën kur ato krijohen. Blerjet dhe shitjet normale të një aktivi financiar janë njohur në datën e tregtimit, në të cilën Banka zotohet të blejë ose të shesë aktivin. Të gjitha aktivet e detyrimet e tjera financiare njihen fillimisht në datën e tregtimit, në të cilën Banka bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit.

Aktivitet dhe detyrimet financiare maten fillimisht me vlerën e drejtë. Kostot e transaksionit që janë të lidhura drejtpërdrejt me blerjen ose emetimin e aktiveve dhe detyrimeve financiare (përveç aktiveve dhe detyrimeve financiare të mbajtura me vlerën e drejtë nëpërmjet pasqyrës së fitimit ose humbjes) shtohen ose zbriten nga vlera e drejtë e aktiveve ose detyrimeve financiare, në përshtatshmëri me njohjen fillestare. Kostot e transaksionit të lidhura drejtpërdrejt me blerjen e aktiveve dhe detyrimeve financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes njihen menjëherë në fitim ose humbje.

(ii) Klasifikimi

Aktivitet financiare klasifikohen në kategori të specifikuar, si vijon: Aktive financiare 'me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes', 'investimet të mbajtura deri në maturim, aktive financiare për shitje, hua dhe të arkëtueshme'. Klasifikimi varet nga natyra dhe qëllimi i aktiveve financiare dhe përcaktohet në kohën e njohjes fillestare. Të gjitha blerjet ose shitjet në mënyrë të rregullt të aktiveve financiare njihen dhe çregjistrohen në datën e tregtimit. Blerje ose shitje të rregullta janë ato blerje ose shitje të aktiveve financiare që kërkojnë transferimin e aktiveve brenda afatit kohor të caktuar të vendosura nga rregullore ose marrëveshje në treg.

Referoju gjithashtu politikave kontabël 3(h), (i) dhe (j).

Banka Kombëtare Tregtare Sh.a.

Shënime mbi Pasqyrat Financiare të Konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013
(shprehur në USD, nëse nuk është shënuar ndryshe)

3. Përmbledhja e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(g) Aktivet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

(iii) Çregjistrimi

Banka çregjistron një aktiv financiar kur të drejtat kontraktuale të flukseve të mjeteve monetare nga aktivi financiar mbarojnë, ose kur transferon aktivin financiar, dhe kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë të aktivit të një palë tjetër. Në qoftë se Banka nuk transferon ose nuk mban kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë dhe vazhdon të kontrollojë aktivin e transferuar Banka vazhdon të njohë interesin e mbartur mbi aktivin dhe pasivin që e shoqëron për shumat që mund të duhet të paguajë. Nëse Banka mbart kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë të një aktivi financiar të transferuar, Banka vazhdon të njohë aktivin financiar dhe gjithashtu njeh një hua të mbuluar me kolateral për të ardhurat e marra. Banka çregjistron detyrimet financiare vetëm, dhe vetëm kur detyrimet e Bankës janë shkarkuar, anuluar ose kanë skaduar. Diferenca midis vlerës kontabël të pasivit financiar të panjohur, dhe shumës së paguar dhe të pagueshme njihet në fitim ose humbje.

Banka merr pjesë në veprime, me anë të të cilave transferon aktive të njohura në pasqyrën e pozicionit financiar, por në të njëjtën kohë ruan kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e aktivit të transferuar ose një pjesë të tyre. Nëse ruhen të gjitha rreziqet dhe përfitimet apo pjesa më e madhe e tyre, atëherë aktivet e transferuara vazhdojnë të njihen në pasqyrën e pozicionit financiar. Transferimi i aktiveve ku ruhen thuajse të gjitha rreziqet dhe përfitimet, përfshin për shembull huadhënien e letrave me vlerë dhe veprimet e riblerjeve.

Kur aktivet i shiten një pale të tretë me një normë totale kthimi konvergjuese në kembim të aktiveve, veprimi konsiderohet si një transaksion financiar i siguruar, i ngjashëm me veprimet e riblerjes.

Banka çregjistron aktivin kur ajo nuk ka kontroll mbi të, në veprimeve ku Banka as nuk ruan dhe as nuk transferon thelbësisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë mbi aktivin financiar. Të drejtat dhe detyrimet që mbahen pas transferimit njihen veçant si aktiv apo detyrim, sipas rastit. Në transferat ku ruhet kontrolli mbi aktivin, Banka vazhdon të njohë aktivin, në masën e përfshirjes së saj në vazhdimësi, që përcaktohet nga masa në të cilën ajo është e ekspozuar ndaj ndryshimit të vlerës së aktivit të transferuar.

Në disa veprime Banka ka detyrimin për të shërbyer aktivin financiar të transferuar kundrejt një tarife. Aktivi i transferuar përfundon së njohuri tërësisht kur plotësohen kriteret e çregjistrimit. Një aktiv apo detyrim përfundon së njohuri për kontratën e shërbimit, varur nga fakti nëse tarifa e shërbimit është më e përshtatshme (aktiv) ose është më pak e përshtatshme (detyrim) për kryerjen e shërbimeve.

Banka bën fshirjen e kredive dhe investimeve kur përcaktohet se ato janë të paarkëtueshme.

(iv) Netimi

Aktivitetet financiare netohen me detyrimet financiare dhe vlera e tyre neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar, atëherë dhe vetëm atëherë kur Banka ka një të drejtë ligjore për të netuar shumat dhe ajo synon ose të shlyejë mbi një bazë neto, ose të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht. Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten mbi baza neto vetëm kur lejohet nga standartet e kontabilitetit, ose për fitime dhe humbje të lindura nga një grup veprimesh të ngjashme si në rastin e aktivitetëve tregtare të Bankës.

(v) Matja e kostos së amortizuar

Kostoja e amortizuar e një aktivi ose detyrimi financiar është vlera me të cilën aktivi ose detyrimi financiar matet në momentin fillestar, duke i zbritur pagesat e këstit, plus ose minus amortizimin e akumuluar duke përdorur metodën e interesit efektiv të çdo diference ndërmjet vlerës fillestare të njohur dhe vlerës në maturim, minus çdo zbritje për efekt zhvlerësimi.

Banka Kombëtare Tregtare Sh.a.

Shënime mbi Pasqyrat Financiare të Konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013

(shprehur në USD, nëse nuk është shënuar ndryshe)

3. Përmbledhja e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(g) Aktivet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

(vi) Matja e vlerës së tregut

Vlera e tregut është shuma me të cilën një aktiv mund të shkëmbehet, ose një detyrim mund të shlyhet, midis palëve të mirëinformuara dhe me vullnet të plotë në kushte të lira tregu në datën e matjes.

Banka e llogarit vlerën e drejtë të një instrumenti duke përdorur çmime të kuotuar në një treg aktiv për atë instrument, në rast se këto janë të disponueshme. Një treg quhet aktiv në qoftë se çmimet e kuotuar janë rregullisht të gatshme dhe paraqesin veprimet aktuale të vazhdueshme në kushte të lira tregu.

Në qoftë se nuk ka treg aktiv për një instrument financiar, Banka vendos vlerën e tregut duke përdorur një teknikë vlerësimi. Teknikat e vlerësimit përfshijnë përdorimin e veprimeve më të fundit të kryera midis palëve të vullnetshme, të mirë informuara (nëse ka të tilla), krahasime me vlerën e drejtë për instrumente të tjerë të ngjashëm, analizat e fluksit monetar të skontuar, modelet e vendosjes së çmimit për opsionet. Teknika e vlerësimit e zgjedhur përdor maksimumin e inputeve të tregut dhe mbështetet sa më pak të jetë e mundur në inputet specifike të Bankës. Ajo përfshin të gjithë faktorët që pjesëmarrësit e tregut do të merrnin parasysh në caktimin e çmimit dhe është në përputhje me metodologjitë e pranuar ekonomike për vlerësimin e instrumenteve financiarë. Inputet për teknikat e vlerësimit pasqyrojnë në mënyrë të arsyeshme pritshmërinë e tregut dhe matjet e faktorëve të rrezikut të kthimit, të qenësishëm në instrumentin financiar. Banka rishikon teknikën e vlerësimit dhe e teston atë për vlefshmëri, duke përdorur çmime nga veprime aktuale të mbikëqyrura lidhur me të njëjtin instrument, ose bazuar në të dhënat e disponueshme e të mbikëqyrura në treg.

Kur një aktiv është blerë ose një pasiv është krijuar në një transaksion këmbimi për atë aktiv ose pasiv, çmimi i transaksionit është çmimi i paguar për të blerë aktivin ose i marrë për të krijuar pasivin (një çmim hyrje). Në të kundërt, vlera e drejtë e aktivit ose detyrimit është çmimi që do të marrë për të shitur aktivin ose paguar për transferimin e detyrimit (një çmim dalje). Në shumë raste çmimi i transaksionit është i barabartë me vlerën e drejtë (që mund të jetë rasti kur në datën e transaksionit, transaksioni për të blerë një aktiv zhvillohet në tregun në të cilin pasuria do të shitet). Në përcaktimin nëse vlera e drejtë në njohjen fillestare është e barabartë me çmimin e transaksionit, Banka merr në konsideratë faktorë të veçantë të lidhur me transaksionin, aktivin ose pasivin.

Kur çmimi i transaksioneve paraqet evidencën më të mirë të vlerës së drejtë në njohjen fillestare, instrumenti financiar matet fillimisht me çmimin e transaksionit dhe çdo diferencë midis këtij çmimi dhe vlerës fillestare të marrë nga një model vlerësimi, është njohur më pas në fitim ose humbje në varësi të fakteve individuale dhe rrethanave të transaksionit, por jo më vonë momentit kur vlerësimi është mbështetur plotësisht nga të dhëna të vëzhgueshme të tregut ose transaksioni është mbyllur.

(vii) Identifikimi dhe matja e zhvlerësimit

Në çdo datë raportimi Banka vlerëson nëse ka evidencë objektive që aktivet financiare të cilat nuk mbahen me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes, janë zhvlerësuar. Aktivet financiare zhvlerësohen nëse evidenca objektive tregon se një ngjarje zhvlerësimi ka ndodhur pas njohjes fillestare të aktivit, dhe që ngjarja e zhvlerësimit ka një ndikim në flukset e ardhshme të mjeteve monetare të aktivit, të cilat mund të maten me besueshmëri.

Treguesit objektivë që aktivet financiare janë të zhvlerësuar mund të përfshijnë mospagesa ose vështirësi financiare të huamarrësit, ristrukturimin e një huaje me kushte dhe afate të cilat Banka nuk do t'i kishte dhënë ndryshe, të dhëna që një huamarrës ose emetues i letrave me vlerë po falimenton, zhdukja e një tregu aktiv për një investim, ose të dhëna të tjera të dukshme lidhur me një grup aktivesh si p.sh ndryshime të pafavorshme në aftësinë paguese të një huamarrësi ose emetuesi të letrave me vlerë, ose kushte ekonomike që lidhen me paaftësi për të paguar Bankën. Për më tepër, rënia e konsiderueshme apo e shtrirë në kohë e vlerës së tregut kundrejt kostos së investimeve për letrat me vlerë të kapitalit është një tregues objektiv zhvlerësimi.

Banka Kombëtare Tregtare Sh.a.

Shënime mbi Pasqyrat Financiare të Konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013
(shprehur në USD, nëse nuk është shënuar ndryshe)

3. Përmbledhja e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(g) Aktivët dhe detyrimet financiare (vazhdim)

(vii) Identifikimi dhe matja e zhvlerësimit (vazhdim)

Banka konsideron treguesit e zhvlerësimit për huatë dhe paradhëniet dhe investime të mbajtura deri në maturim si individualisht ashtu edhe në mënyrë kolektive. Të gjitha huatë e paradhëniet dhe investimet e mbajtura deri në maturim të cilat janë individualisht të rëndësishme, vlerësohen për zhvlerësim specifik. Për të gjitha huatë e paradhëniet dhe investimet e mbajtura deri në maturim të cilat janë individualisht të rëndësishme, të cilat nuk janë për t'u zhvlerësuar specifikisht, kryhet një rishikim për zhvlerësim në grup, që ka ndodhur, por nuk është identifikuar ende.

Të gjitha huatë dhe investimet e mbajtura deri në maturim, të cilat nuk janë individualisht të rëndësishme, vlerësohen në mënyrë kolektive për zhvlerësim duke grupuar së bashku huatë e financimet dhe investimet e mbajtura deri në maturim që kanë karakteristika të ngjashme rreziku.

Humbja nga zhvlerësimi i një aktivi financiar të matur me koston e amortizuar është llogaritur si diferencë ndërmjet vlerës kontabël të aktivitetit dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të vlerësuar, të skontuara me normën fillestare të interesit efektiv të aktivitetit financiar. Humbjet njihen në fitim ose humbje dhe pasqyrohen në një llogari provizioni përkundrejt huave. Interesat mbi aktivet e zhvlerësuar vazhdojnë të njihen nëpërmjet skontimeve të pandryshueshme. Kur një ngjarje pas datës së raportimit shkakton pakësim të zhvlerësimit, zvogëlimi i zhvlerësimit rimerret nëpërmjet fitimit ose humbjes.

Humbja nga zhvlerësimi i letrave me vlerë të mbajtura për shitje njihet duke transferuar humbjen kumulative, e cila është njohur direkt në të ardhura të tjera përmbledhëse të fitim/humbjes. Humbja kumulative që është riklasifikuar nga të ardhura të tjera përmbledhëse në fitim/humbje është diferenca ndërmjet koston së blerjes, së cilës i zbriten ripagimet e principalit dhe amortizimi, dhe vlerës së tregut aktuale së cilës i zbritet zhvlerësimi që është njohur më parë në fitim/humbje. Ndryshimet që i atribuohen vlerës në kohë të parasë, janë reflektuar si një komponent i të ardhurave nga interesi. Nëse, në një periudhë të ardhme, vlera e tregut e një letre me vlerë të vlefshme për shitje të zhvlerësuar më parë rritet, dhe rritja lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes në fitim/humbje të humbjes nga zhvlerësimi, kjo humbje nga zhvlerësimi kthehet mbrapsht me shumën e kthimit të njohur në fitim ose humbje.

(h) Mjete monetare dhe ekuivalente me to

Mjetet monetare dhe ekuivalentet me to përfshijnë kartëmonedha dhe monedha në arkë, gjendje të pakushtëzuara në bankat qendrore dhe të tjera aktive financiare shume likuide, me maturitet origjinal tre muaj ose më pak, subjekt i një rreziku jo domethënës ndaj ndryshimeve në vlerën e tyre të drejtë, dhe që përdoren nga Banka në administrimin e angazhimeve afatshkurtra. Mjetet monetare dhe ekuivalentet me to mbahen në pasqyrën e pozicionit financiar me kosto të amortizuar.

(i) Derivatët e mbajtur për menaxhimin e riskut

Derivatët e mbajtur për menaxhimin e riskut përfshijnë të gjithë aktivet dhe detyrimet derivative, të cilat nuk klasifikohen në aktivet apo detyrimet e tregtueshme. Derivatët e mbajtur për qëllime të administrimit të riskut mbahen në pasqyrën e pozicionit financiar me vlerën e tregut.

(j) Hua

Huatë dhe paradhëniet janë aktive financiare jo-derivative, me pagesa fikse ose të përcaktuara, të cilat nuk janë kuotuar në tregje aktive dhe Banka nuk ka për qëllim t'i shesë menjëherë apo në periudhën afatshkurtër.

Kur Banka blen një aktiv financiar dhe njëherësh hyn në një marrëveshje për ta rishitur këtë aktiv (apo aktiv shumë të ngjashëm me të) me një çmim të fiksuar në një datë të ardhshme ("marrëveshje të anasjella të riblerjes"), marrëveshja kontabilizohet si një hua apo paradhënie dhe aktivet në bazë të marrëveshjes nuk paraqiten në pasqyrat financiare të Bankës.

Huatë fillimisht maten me vlerën e drejtë plus kosto të tjera direkte të veprimit, dhe në vijim maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, përveç rastit kur Banka zgjedh të mbajë huatë dhe paradhëniet me vlerën e tregut nëpërmjet fitim/humbjes siç përshkruhet në politikat kontabël 3(g),(vi).

Banka Kombëtare Tregtare Sh.a.

Shënime mbi Pasqyrat Financiare të Konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013

(shprehur në USD, nëse nuk është shënuar ndryshe)

3. Përmbledhja e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(k) Investime

Investimet njihen fillimisht me vlerë të drejtë, dhe në rastin e investimeve jo me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, plus kostot shtesë të veprimit direkt, dhe më pas regjistrohen në varësi të klasifikimit si të mbajtura deri në maturim, ose të vlefshme për shitje.

(i) Investime të mbajtura deri në maturim

Investimet që mbahen deri në maturim janë aktive financiare jo-derivative me pagesa fikse ose të përcaktuara dhe maturitet të përcaktuar, të cilat Banka ka synimin e qartë dhe aftësinë t'i mbajë deri në maturim, dhe të cilat nuk janë përcaktuar si me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes ose si të vlefshme për shitje.

Investimet që mbahen deri në maturim mbahen me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Çdo rast shitje ose riklasifikimi përpara maturimit, të një sasive më shumë se sa të rëndësishme të investimeve që mbahen deri në maturim, do të sillte riklasifikimin e të gjithë investimeve që mbahen deri në maturim si të vlefshme për shitje, dhe kjo do ta pengonte Bankën të klasifikonte investimet si të mbajtura deri në maturim, gjatë periudhës aktuale dhe gjatë dy viteve financiarë pasues.

(ii) Investime të vlefshme për shitje

Investime e mbajtura për tregtim janë instrumente jo-derivative të cilat janë klasifikuar si të mbajtura për shitje ose nuk janë klasifikuar si ndonjë kategori tjetër e aktiveve financiare. Investimet e mbajtura për tregtim mbahen me vlerën e drejtë.

Të ardhurat nga interesi njihen në fitim/humbje duke përdorur metodën e interesit efektiv. Fitimi ose humbja nga kursi i këmbimit për investime në letra me vlerë të mbajtura për shitje njihet në fitim/humbje.

Ndryshime të tjera në vlerën e tregut njihen direkt në të ardhura të tjera përmbledhëse deri në momentin kur investimi shitet ose zhvlerësohet, moment kur humbjet ose fitimet kumulative të njohura më parë në të ardhura të tjera përmbledhëse, njihen në fitim ose humbje.

(l) Aktive të qëndrueshme të trupëzuara

(i) Njohja dhe matja

Zërat e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara paraqiten me kosto, minus zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga rënia në vlerë.

Kosto përfshin shpenzime që janë drejtpërdrejt të lidhura me blerjen e aktivitetit.

Kur pjesë të një elementi të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara kanë jetëgjatësi të dobishme të ndryshme, ato kontabilizohen si elemente të veçanta (komponentët kryesorë) të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara.

(ii) Kostot vijuese

Kostoja e zëvendësimit të një pjese a të një elementi të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të elementit, nëse është e mundshme që Banka në të ardhmen të ketë përfitime ekonomike, që i atribuohen atij elementi, dhe nëse kostoja e tij mund të matet me besueshmëri. Vlera kontabël e pjesës së zëvendësuar çregjistrohet. Kostot e shërbimeve ditore të aktiveve afatgjata materiale njihen në fitim ose humbje në momentin kur ndodhin.

(iii) Zhvlerësimi

Zhvlerësimi njihet në fitim ose humbje në mënyrë lineare përgjatë jetës së dobishme të çdo zëri të aktiveve afatgjata të trupëzuara. Toka nuk zhvlerësohet.

Vlerësimi për jetën e dobishme për periudhën aktuale dhe atë krahasuese është si më poshtë:

- | | |
|--|---------|
| • Ndërtesa dhe përmirësime të ambjenteve me qera | 20 vjet |
| • Mjete transporti dhe pajisje të tjera | 5 vjet |
| • Pajisje zyre | 5 vjet |
| • Kompjuterat dhe pajisje elektronike | 4 vjet |

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi.

Banka Kombëtare Tregtare Sh.a.

Shënime mbi Pasqyrat Financiare të Konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013

(shprehur në USD, nëse nuk është shënuar ndryshe)

3. Përmbledhja e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(m) Aktive të qëndrueshme të patrupëzuara

Zërat e aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara përfshijnë programet kompjuterike të blera nga Banka. Programet kompjuterike të blera nga Banka njihen me koston historike zvogëluar me amortizimin dhe humbjet e akumuluar nga rënia në vlerë.

Shpenzimet për zhvillimin e programeve kompjuterike nga vetë Banka njihen si aktive kur Banka është në gjendje të tregojë qëllimin dhe aftësinë për të plotësuar zhvillimin dhe përdorur programet kompjuterike në një mënyrë që do të gjenerojë përfitime ekonomike të ardhme, dhe mundet të masë me besueshmëri kostot e përfundimit të zhvillimit. Kapitalizimi i kostove të programeve të zhvilluara nga vetë Banka përfshin të gjithë kostot që i atribuohen direkt zhvillimit të programit kompjuterik dhe amortizohen me jetën e dobishme të tyre. Zhvillimi nga vetë Banka i programeve kompjuterike shprehet me koston e kapitalizuar duke i zbritur amortizimin e akumuluar dhe rënie në vlerë.

Shpenzime vijuese për programet kompjuterike kapitalizohen vetëm kur këto shpenzime ndikojnë në rritjen e përfitimit të ardhshëm ekonomik të aktivitetit të cilit i ngarkohen. Të gjitha shpenzimet e tjera njihen në periudhën kur ndodhin.

Amortizimi njihet në fitim ose humbje në mënyrë lineare përgjatë jetës së dobishme të programit kompjuterik duke filluar nga data në të cilën ky program është i gatshëm për përdorim. Jeta e dobishme e programeve kompjuterike është vlerësuar në katër vjet.

(n) Aktivitetet e përfituara nga procesi ligjor

Aktivitetet e përfituara nga procesi ligjor, janë përfutur përmes ekzekutimit të garancisë mbi të arkëtueshmet financiare dhe kontabilizohen në varësi të klasifikimit të tyre si aktiv afatgjatë i mbajtur për shitje, apo si aktive afatgjata të investimit.

(i) Aktive afatgjata që mbahen për t'u shitur

Aktivitetet afatgjata të mbajtura për t'u shitur pritet të rikuperohen kryesisht nëpërmjet shitjes dhe jo kundrejt përdorimit të vazhdueshëm. Menjëherë para klasifikimit si të mbajtura për t'u shitur, aktivitetet rimaten sipas politikave kontabël të Bankës. Prej atij momenti, aktivitetet maten me më të voglën mes vlerës kontabël dhe vlerës së tregut minus kostot e shitjes. Humbjet nga zhvlerësimi në klasifikimin fillestar dhe humbjet apo fitimi nga rimatja në vijimësi, njihen në fitim/humbje. Fitimet njihen deri në masën që nuk tejkalojnë ndonjë humbje kumulative nga rënia në vlerë.

(ii) Aktivitetet afatgjata të investimit

Një aktiv afatgjatë i investimit është aktiv afatgjatë i mbajtur për të përfituar të ardhura nga qiraja, ose për fitime kapitale, ose për të dyja, por jo për përdorim në aktivitetet ose furnizimin e të mirave apo shërbimeve, apo për qëllime administrative. Aktivitetet afatgjata të investimit maten me vlerën e drejtë referuar çmimeve të tregut, me çdo ndryshim të vlerës së tyre, të njohur në fitim ose humbje. Kur përdorimi i një aktiviteti afatgjatë ndryshon, atëherë ai riklasifikohet si prona dhe pajisje, vlera e drejtë e aktivitetit në datën e riklasifikimit bëhet kostoja e tij për kontabilizimin e mëtejshëm.

(o) Rënia e vlerës e aktiveve jo-financiare

Vlera kontabël e aktiveve jo-financiare të Bankës, përveç aktiveve tatimore të shtyra, rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka tregues për rënie vlere. Nëse ka tregues të tillë, atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit.

Humbja nga rënia në vlerë njihet nëse vlera kontabël e një aktiviteti ose e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare tejkalon vlerën e rikuperueshme. Njësia gjeneruese e mjeteve monetare është grupi më i vogël i identifikueshëm i aktiveve që gjeneron flukse monetare që janë të pavarura nga aktivitetet dhe grupet e tjera. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje. Humbjet nga zhvlerësimi të matura për njësi gjeneruese të mjeteve monetare, fillimisht zvogëlojnë vlerën kontabël të ndonjë aktiviteti jo-material që është pjesë e njësisë dhe pastaj redukton vlerën kontabël të aktiveve të tjera në njësi (apo grup njësisish) me një shpërndarje proporcionale mes tyre.

Vlera e rikuperueshme e një aktiviteti ose e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare është më e madhja ndërmjet vlerës në përdorim dhe vlerës së tij të drejtë minus kostot e shitjes. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset monetare të vlerësuarara të ardhshme janë skontuar në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para taksave, që reflekton vlerësimin aktual të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike për aktivitetin. Humbjet nga zhvlerësimi të njohura në periudhat e mëparshme vlerësohen në çdo datë raportimi për evidencë nëse humbja është zvogëluar ose nuk ekziston më.

Banka Kombëtare Tregtare Sh.a.

Shënime mbi Pasqyrat Financiare të Konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013

(shprehur në USD, nëse nuk është shënuar ndryshe)

3. Përmbledhja e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(o) Rënia e vlerës e aktiveve jo-financiare (vazhdim)

Një humbje për zhvlerësim anulohet nëse ka patur ndryshim në vlerësimet e përdorura për përcaktimin e vlerës së rikuperueshme. Humbja nga zhvlerësimi anulohet deri në atë masë sa vlera kontabël e aktivitetit nuk tejkalon vlerën kontabël që do të përcaktohej duke i zbritur zhvlerësimin ose amortizimin, sikur të mos ishte njohur ndonjë humbje nga rënia e vlerës.

(p) Investime në pjesëmarrje

Një investim në pjesëmarrje është një entitet mbi të cilin Banka ka një ndikim të rëndësishëm. Ndikim i rëndësishëm është fuqia për të marrë pjesë në vendimet mbi politikat operacionale dhe financiare të filialit, por nuk është një kontroll i plotë ose një kontroll i përbashkët i këtyre politikave.

Rezultatet dhe pozicionet financiare të pjesëmarrjeve janë përfshirë në këto pasqyra financiare të konsoliduara duke përdorur metodën e kapitalit në kontabilizim, përveç kur investimi është klasifikuar si i mbajtur për shitje, rast në të cilin është kontabilizuar në përputhje me SNRF 5. Sipas metodës së kontabilizimit të kapitalit, një investim në një pjesëmarrje njihet fillimisht në pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar me kosto dhe rregullohet më pas për të njohur pjesën e Bankës, të fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse të pjesëmarrjes. Kur pjesa e humbjeve të Bankës në një pjesëmarrje tejkalon interesin e Bankës në atë pjesëmarrje (i cili përfshin ndonjë interes afatgjatë që, në thelb, janë pjesë e investimit neto të Bankës në pjesëmarrje), Banka ndërpret njohjen e aksioneve të saj, duke pranuar pjesën e saj të humbjeve të mëtejshme. Humbjet shtesë njihen vetëm në masën që Banka ka detyrime ligjore ose konstruktive apo ka kryer pagesa të bëra në emrin e pjesëmarrjes.

Kërkesat e SNK 39 zbatohen për të përcaktuar nëse është e nevojshme për të njohur ndonjë humbje nga zhvlerësimi në lidhje me investimet e Bankës në një pjesëmarrje. Kur është e nevojshme, e gjithë vlera kontabël e investimit testohet për zhvlerësim në përputhje me SNK 36 Zhvlerësimi i Aktiveve si një aktiv të vetëm duke krahasuar shumën e tij të rikuperueshme (vlerën më të lartë midis vlerës në përdorim dhe vlerës së drejtë minus kostot e shitjes) me vlerën e tij kontabël. Çdo humbje e njohur nga zhvlerësimi është pjesë e vlerës kontabël të investimit. Çdo rimarrje e kësaj humbjeje nga zhvlerësimi njihet në përputhje me SNK 36 deri në masën që shumën e rikuperueshme të investimit më pas të rritet.

Me shitjen apo nxjerrjen jashtë përdorimit të një pjesëmarrjeje e cila rezultojnë në humbjen e ndikimit të rëndësishëm nga ana e Bankës në atë pjesëmarrje, çdo investim i mbajtur matet me vlerën e drejtë në atë datë dhe si vlerë e drejtë konsiderohet vlera e drejtë në njohjen fillestare si një aktiv financiar në përputhje me SNK 39. Diferenca midis vlerës kontabël të mëparshme të pjesëmarrjes që i takon interesit të mbartur dhe vlerës së drejtë, përfshihet në përcaktimin e fitimit ose humbjes nga nxjerrja jashtë përdorimit të pjesëmarrjes. Gjithashtu, të gjitha shumtë e njohura më parë në të ardhura të tjera përmbledhëse në lidhje me këtë pjesëmarrje, Banka i konsideron në të njëjtën mënyrë siç do të kërkohej nëse pjesëmarrja do të kishte nxjerrje jashtë përdorimit në mënyrë të drejtpërdrejtë aktivitet ose detyrimet e lidhura me të. Si pasojë, në qoftë se një fitim ose humbje e njohur më parë në të ardhura të tjera përmbledhëse nga ajo pjesëmarrje do të riklasifikohet në fitim ose humbje nga nxjerrja jashtë përdorimit të aktiveve ose detyrimeve të lidhura me të, Banka riklasifikon fitimin ose humbjen nga kapitali në fitim ose humbje (si rregullim riklasifikimi) kur ajo humbet ndikimin e rëndësishëm mbi atë pjesëmarrje.

(q) Depozitat dhe huatë (përfshirë detyrimet e vonuara)

Depozitat dhe huatë (përfshirë detyrimet e vonuara) janë pjesë e burimeve të financimit të Bankës. Kur Banka shet një aktiv financiar dhe njëkohësisht hyn në një marrëveshje për të riblerë këtë aktiv (ose një aktiv të ngjashëm) me një çmim fiks në të ardhmen ("repo" ose "huadhenie aksioni"), marrëveshja kontabilizohet si një depozitë, dhe aktivi vazhdon të njihet në pasqyrat financiare të Bankës.

Depozitat dhe huatë (përfshirë detyrimet e vonuara) maten fillimisht me vlerën e drejtë plus kosto të tjera direkte të veprimit, dhe në vijim maten me kosto të amortizuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

(r) Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i ngjarjeve të shkuara, Banka ka një detyrim ligjor ose konstruktiv të tanishëm i cili mund të matet në mënyrë të besueshme, dhe ka mundësi që për të shlyer detyrimin, të kërkohej një dalje e të mirave ekonomike. Provizionet janë përcaktuar duke skontuar flukset e pritshme monetare me një normë skontimi para taksave që reflekton vlerësimin aktual të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe, sipas rastit, reziqet specifike të detyrimit.

Banka Kombëtare Tregtare Sh.a.

Shënime mbi Pasqyrat Financiare të Konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013
(shprehur në USD, nëse nuk është shënuar ndryshe)

3. Përmbledhja e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(r) Provizionet (vazhdim)

Një provizion për ristrukturimin njihet kur Banka ka aprovuar një plan ristrukturimi të detajuar dhe formal dhe ristrukturimi ka filluar apo është publikuar. Kostot e ardhme operative nuk provizionohen.

Një provizion për kontratat pa fitim njihet kur përfitimet e pritshme për t'u marrë nga Banka për këto kontrata, janë më të vogla se kostot e pashmangshme për të plotësuar detyrimin sipas kontratës. Provizioni matet me vlerën aktuale të më të voglës mes kostos së pritshme të përfundimit të kontratës dhe kostos neto të pritshme për të vazhduar me kontratën. Para se një provizion të krijohet, Banka njihet çdo humbje zhvlerësimi të aktiveve që lidhen me atë kontratë.

(s) Përfitimet e punonjësve

(i) Plan pensioni me kontribute të përcaktuara

Detyrimet për kontributet ndaj planit të pensioneve me kontribute të përcaktuara njihen si shpenzim në fitim ose humbje kur ato ndodhin. Banka paguan kontributet e detyrueshme për sigurimet shoqërore që mbulojnë përfitimet e punonjësve pasi dalin në pension. Autoritetet vendase janë përgjegjëse për dhënien e limitit minimal ligjor të vendosur për pensionet në Shqipëri sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

(ii) Plani i përfitimit të pensionit

Banka ka krijuar një fond plan pensioni, plotësisht të financuar nga punëdhënësi i quajtur Programi i Mbështetjes së Stafit (shiko shënimin 22 "Fondi rezervë për punonjësit që dalin në pension") në vitin 2002. Shuma që regjistrohej tek ky fond ("PMS") vendosej në fillim të vitit në masën 5% të shpenzimeve vjetore të planifikuara për pagat e personelit.

Sipas planit të mësipërm, shumës së përlogaritur për punonjësit i shtohet interesi, i cili llogaritet që nga data kur punonjësit do të largoheshin dhe deri në daljen e tyre në pension. Kjo shumë do t'i paguhet punonjësve, vetëm kur ata të mbërrijnë moshën e pensionit, përcaktuar sipas ligjit shqiptar, në këste mujore të barabarta me minimumin e 75% e pensionit mujor shtetëror derisa fondi i akumuluar për punonjësit të konsumohet.

Bazuar në rezolutën e Këshillit Drejtues, në fuqi që nga 30 shtatori 2010, Banka ka ndaluar së investuari në këtë fond ("PMS"), duke e transformuar atë në Programin e Kredisë për Mbajtjen e Stafit ("PKMS"). Ndryshimet demografike në forcën punëmarrëse gjatë dhjetë viteve të fundit dhe moshën mesatare 31 vjeç e punonjësve, ku 80% e punonjësve janë nën moshën 40 vjeç, ka rezultuar se PMS nuk është tërheqëse për pjesën më të madhe të punonjësve të Bankës, pasi mund të gëzohet vetëm me daljen në pension. Në dallim nga ky plan, PKMS do të jetë më i dobishëm për të gjithë punonjësit e Bankës, sepse do të ofrojë kredi për shtëpi apo kredi konsumatore me terma preferencialë. Shuma e llogaritur për personat përfitues nga Programi i Mbështetjes së Stafit është ngrirë në të njëjtën datë. Shuma e ngrirë si pasojë e transformimit të programit të "PMS" në "PKMS" më 30 shtator 2010 dhe pjesa korresponduese e interesit vjetor, që do fitohet në të ardhmen deri në moshën e pensionit, matet në bazë të normës së obligacioneve qeveritare AAA, dhe regjistrohet si detyrim nga Banka.

(iii) Përfitimet afat-shkurtra

Detyrimet e përfitimeve afat-shkurtër të punonjësve maten në baza të paskontuara dhe janë shpenzuar sipas kryerjes së shërbimit lidhur me to.

Për shumën që pritet të paguhet sipas përfitimit monetar afat-shkurtër ose planeve të ndarjes së fitimeve, nëse Banka ka një detyrim aktual ligjor ose konstruktiv të paguajë këtë shumë si rezultat i shërbimeve të kaluara të kryera nga punonjësit dhe detyrimet mund të maten në mënyrë të besueshme, njihet provizion.

(t) Raportimi i segmenteve

Një segment operues është një komponent i Bankës që është i përfshirë në aktivitete biznesi, nga të cilat mund të fitojë të ardhura dhe të kryejë shpenzime, duke përfshirë të ardhurat dhe shpenzimet që lidhen me veprimet me komponentë të tjerë të Bankës, dhe rezultatet operative të të cilit, rishikohen në mënyrë të rregullt nga menaxhimi për të marrë vendime rreth ndarjes së burimeve të secilit segment dhe për të vlerësuar performancën e tyre, dhe për të cilin duhet informacion i veçantë i vlefshëm (shih shënimin 6). Forma e përdorur prej Bankës për raportim të segmentuar është bazuar në segmentimin gjeografik.

Banka Kombëtare Tregtare Sh.a.

Shënime mbi Pasqyrat Financiare të Konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013

(shprehur në USD, nëse nuk është shënuar ndryshe)

3. Përmbledhja e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(u) Standardet dhe interpretimet në fuqi në periudhën aktuale

Standardet e mëposhtme, amendimet mbi standardet dhe interpretimet ekzistuese të lëshuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit, janë efektive për periudhën aktuale:

- **SNRF 10 "Pasqyrat Financiare të Konsoliduara"** të publikuara nga BSNK më 12 maj 2011. SNRF 10 zëvendëson udhëzimet e konsolidimit në SNK 27 Pasqyrat Financiare të Konsoliduara dhe Individuale dhe KIS-12 Konsolidimi - Njësitë ekonomike për qëllime te vecanta, duke futur një model të vetëm për konsolidimin e të gjitha subjekteve duke u bazuar në kontroll, pavarësisht nga natyra e të investuarit (p.sh., nëse një njësi ekonomike kontrollohet me anë të drejtave të votimit të investitorëve apo përmes marrëveshjeve të tjera kontraktuese siç është e zakonshme në subjektet qëllim të veçantë). Sipas SNRF 10, kontrolli është i bazuar në nëse një investitor ka 1) pushtet mbi të investuarit; 2) ekspozimi, ose të drejta, me kthime të ndryshueshme nga përfshirja e saj me të investuarin; dhe 3) aftësia për të përdorur fuqinë e saj mbi të investuarin që të ndikojnë në shumën e kthimit. (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas 1 janarit 2013),
- **SNRF 11 "Marrëveshjet e përbashkëta"** të publikuara nga BSNK më 12 maj 2011. SNRF 11 paraqet kërkesat e reja kontabël për marrëveshjet e përbashkëta, duke zëvendësuar SNK 31 Interesat në Sipërmarrjet e Përbashkëta. Mundësia për të aplikuar metodën e konsolidimit proporcional të kontabilitetit për njësitë ekonomike të kontrolluara bashkërisht është hequr. Përveç kësaj, SNRF 11 eliminon të aktivet e kontrolluara bashkërisht për tani vetëm me dallimin midis operacioneve të përbashkëta dhe ndërmarrjeve të përbashkëta. Një operacion i përbashkët është një marrëveshje e përbashkët ku palët që kanë kontroll të përbashkët kanë të drejta të aktiveve dhe pasiveve për detyrimet. Një ndërmarrje e përbashkët është një marrëveshje e përbashkët ku palët që kanë kontroll të përbashkët kanë të drejta të aktiveve neto. (E vlefshme për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas 1 janarit 2013),
- **SNRF 12 "Dhënia e informacioneve shpjeguese të Interesave në subjekte të tjera"** të publikuara nga BSNK më 12 maj 2011. SNRF 12 do të kërkojë dhënie informacionesh shpjeguese të zgjeruara për të dy njësitë e konsoliduara dhe subjekte të pakonsoliduara në të cilat një njësi ekonomike ka përfshirje. Objektivi i SNRF 12 është që të kërkojë informacion në mënyrë që përdoruesit e pasqyrave financiare mund të vlerësojnë bazën e kontrollit, çdo kufizim mbi aktivet dhe detyrimet të konsoliduara, ekspozimeve të rrezikut që dalin nga përfshirja me subjekte të pakonsoliduara të strukturuar dhe jo të kontrollueshme në përfshirjen e bartësve të interesit në aktivitetet e subjekte të konsoliduara. (Në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas 1 janarit 2013),
- **SNRF 13 "Matja e vlerës së drejtë"**, publikuar nga BSNK më 12 maj 2011. SNRF 13 përcakton vlerën e drejtë, jep udhëzime për të përcaktuar vlerën e drejtë dhe kërkon dhënie të informacioneve shpjeguese në lidhje me matjet e vlerës së drejtë. Megjithatë, SNRF 13 nuk ndryshon kërkesat në lidhje me objekte të cilat duhet të maten ose janë shpalosur me vlerën e drejtë. (Në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas 1 janarit 2013),
- **SNK 27 (i rishikuar në vitin 2011) "Pasqyrat financiare të veçanta"** (Në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas 1 janarit 2013),
- **SNK 28 (i rishikuar në vitin 2011) "Investimet në Pjesëmarrje dhe sipërmarrjet e përbashkëta"** (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas 1 janarit 2013),
- **Ndryshimet në SNRF 1 "Aplikimi për herë të parë i SNRF"** - Kredite të dhena Qeverise (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas 1 janarit 2013),
- **Ndryshimet në SNRF 7 "Instrumentet Financiare: Dhënia e informacioneve shpjeguese"** - Kompensimi i aktiveve financiare dhe pasiveve financiare (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas 1 janarit 2013),
- **Amendime "Pasqyrave të Konsoliduara Financiare" SNRF 10, SNRF 11 "Marrëveshjet e përbashkëta" dhe SNRF 12 "Dhënia e informacioneve shpjeguese të Interesave në subjekte të tjera"** - Udhëzuese Tranzicion (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas 1 janarit 2013),
- **Ndryshimet në SNK 1 "Paraqitja e pasqyrave financiare"** - Prezantimi i Artikujve të tjera të te ardhurave të përgjithshme (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas 1 korrikut 2012),

Banka Kombëtare Tregtare Sh.a.

Shënime mbi Pasqyrat Financiare të Konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013
(shprehur në USD, nëse nuk është shënuar ndryshe)

3. Përmbledhja e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(u) Standardet dhe interpretimet në fuqi në periudhën aktuale (vazhdim)

- **Ndryshime në SNK 19 "Përfitimet e Punonjësve"** - Përmirësimi i Kontabilitetit për Përfitimet e pas- punësimit (ne fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas 1 janar 2013),
- **Ndryshimet në disa standarde "Përmirësimet në SNRF (të ciklit 2009-2011)"** që rezultojnë nga projekti vjetor përmirësimet në cilësi të SNRF (SNRF 1, SNK 1, SNK 16, SNK 32, SNK 34) kryesisht me qëllim shmangjen e mospërputhjet dhe përmirësimin e tekstit (Ndryshimet duhet të zbatohen për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas 1 janarit 2013).
- **KIRFN 20 "Shpenzimet e nxjerrjes në fazën e prodhimit të një sipërfaqeje miniere"** (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2013).

Aplikimmi i këtyre ndryshimeve të standardeve dhe interpretimeve ekzistuese nuk ka sjellë ndryshim në politikat kontabël të Bankës.

(v) Standardet dhe Interpretimet në publikim akoma jo në fuqi

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare, standardet, rishikimet dhe interpretimet e mëposhtme ishin publikuar, por nuk ishin akoma në fuqi:

- **SNRF 9 "Instrumentet Financiare" dhe ndryshimet e mëvonshme të publikuara nga BSNK më 12 nëntor 2009.** Më 28 tetor 2010, BSNK ribotohet SNRF 9, duke përfshirë kërkesat e reja për kontabilizimin e detyrimeve financiare dhe duke mbajtur nga SNK 39 kërkesat për çregjistrimin e aktiveve financiare dhe pasiveve financiare. Më 19 nëntor 2013 BSNK publikoi një paketë ndryshimesh në kërkesat e kontabilitetit për instrumentet financiare. Standardi përdor një qasje të vetme për të përcaktuar nëse një aktiv financiar matet me koston e amortizuar ose vlerën e drejtë, duke zëvendësuar rregullat e shumta në SNK 39. Metodologjia e SNRF 9 është bazuar në atë se si një njësi ekonomike menaxhon instrumentet e saj financiare (sipas modelit të biznesit) dhe karakteristikat e rrjedhjes së pasasë të aktiveve financiare. Standardi i ri gjithashtu do të kërkojë të përdoret një metode zhvlerësimi, duke zëvendësuar shumë metoda të ndryshme të zhvlerësimit në SNK 39. Kërkesat e reja për kontabilizimin e detyrimeve financiare paraqesin problemin e luhatshmërisë në fitim ose humbje që rrjedh nga një emetues zgjedhur për të matur vete borxhit me vlerën e drejtë. BSNK vendosi të mbajë matjen e koston ekzistuese të amortizuar për shumicën e detyrimeve, duke kufizuar ndryshim me atë që kërkohet për të trajtuar problemin e vet të kreditit. Me kërkesat e reja, një njësi ekonomike zgjedh për të matur një pasiv me vlerën e drejtë do të paraqesë pjesën e ndryshimit në vlerën e drejtë të tij për shkak të ndryshimeve në vetë rrezikun e kredisë të njësisë ekonomike në seksionin e tjera përmbledhëse e të ardhurave të pasqyrës së të ardhurave, në vend se në fitim ose humbje. Ndryshimet nga nëntor 2013 do të sjellin në fuqi një rishikim të konsiderueshem të kontabilitetit që do të lejojë njësitë ekonomike për të pasqyruar më mirë aktivitetet e tyre të menaxhimit të riskut në pasqyrat financiare. Kjo i lejon ndryshimet për të paraqitur atë çështje 'kreditit vetë' që është i përfshirë tashmë në SNRF 9 Instrumentat Financiarë dhe që do të aplikohet në mënyrë të izoluar pa pasur nevojë për të ndryshuar ndonjë tjetër për instrumentet financiare. Ajo gjithashtu heq datën e detyrueshme në fuqi 1 janar 2015 të SNRF 9, për të siguruar kohë të mjaftueshme për hartuesit e pasqyrave financiare për të bërë kalimin në kërkesat e reja (Më 20 shkurt, 2014, BSNK vendosi që data efektive për SNRF 9 do të jetë 1 janar 2018),
- **SNRF 14 "Llogaritë rregullatore të shtyrjes"** (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2016),
- **Ndryshimet e "Pasqyrave të Konsoliduara Financiare" SNRF 10, SNRF 12 "Shpalosjet e interesave në entitetet e tjera" dhe SNK 27 "Pasqyrat financiare të veçanta"** - Njësitë ekonomike për investime (ne fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2014),
- **Ndryshime në SNK 19 "Përfitimet e Punonjësve"** - të caktuara Planet Benefit : Kontributet e punonjësve (ne fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas 1 korrik 2014),

Banka Kombëtare Tregtare Sh.a.

Shënime mbi Pasqyrat Financiare të Konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013
(shprehur në USD, nëse nuk është shënuar ndryshe)

3 . Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(v) Standarde dhe Interpretime në publikim akoma jo në fuqi (vazhdim)

- Ndryshimet në SNK 32 “Instrumentet Financiare : Paraqitja ” - Kompensimi i aktiveve financiare dhe pasiveve financiare (ne fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2014) ,
- Ndryshimet në SNK 36 “Zhvlerësimi i asetëve” - Shpalosjet e shumës së rikuperueshme për Aktivet jo-financiare (ne fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2014) ,
- Ndryshimet në SNK 39 “Instrumentet Financiare : Njohja dhe Matja ” - Risitë e derivativëve dhe vazhdimësia e kontabilitetit mbrojtës (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2014),
- Ndryshimet në disa standarde “ Përmirësimet në SNRF (cikli 2010-2012) ” që rezultojnë nga projekti vjetor i përmirësimeve në cilësi të SNRF (SNRF 2 , SNRF 3, SNRF 8, SNRF 13, SNK 16, SNK 24 dhe SNK 38) kryesisht me qëllim që të shmangin mospërputhjet dhe të qartësojnë formulimin (ndryshimet duhet të zbatohen për periudhat vjetore që fillojnë më datën 1 korrik 2014) ,
- Ndryshimet në disa standarde “ Përmirësimet në SNRF (të ciklit 2011-2013) ” që rezultojnë nga projekti vjetor përmirësimit në cilësi të SNRF (IFRS 1 , SNRF 3 , SNRF 13 dhe SNK 40) kryesisht me qëllim që të shmangin mospërputhjet dhe përmirësimin e tekstit (ndryshimet që duhet të zbatohen për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas 1 korrik 2014) ,
- KIRFN 21 “Taksimi” (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2014).

Banka ka zgjedhur të mos i aplikojë këto standarde, rishikime dhe interpretime përpara datës së hyrjes në fuqi. Përveç ndikimit të SNRF 9, i cili do të vlerësohet nga Banka gjatë vitit 2014, Banka parashikon se aplikimi i standardeve të tjera, të rishikimeve dhe interpretimeve nuk do të ketë ndikim material në pasqyrat e konsoliduara financiare të Bankës në periudhën e zbatimit fillestar.

Banka Kombëtare Tregtare Sh.a.

Shënime mbi Pasqyrat Financiare të Konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013
(shprehur në USD, nëse nuk është shënuar ndryshe)

4. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Drejtimi diskuton me Komitetin e Auditimit mbi zhvillimin, zgjedhjen dhe shënimet shpjeguese të politikave dhe vlerësimeve kritike të Bankës, dhe aplikimin e këtyre politikave dhe vlerësimeve.

Këto shënime shpjeguese mbështesin komentet mbi administrimin e rrezikut financiar (shih shënimin 5).

Fonde për humbjet nga zhvlerësimi i kredive

Aktivët e regjistruara me kosto të amortizuar vlerësohen për zhvlerësim në bazë të politikave kontabël të përshkruara në 3(g)(vii).

Banka rishikon portofolin e kredive për të përcaktuar zhvlerësimin në baza mujore. Në përcaktimin nëse humbja nga zhvlerësimi duhet të regjistrohet në fitim/humbje, Banka bën gjykime nëse ka të dhëna që tregojnë se ka një rënie të konsiderueshme në flukset e vlerësuarat monetare të ardhme nga portofoli i kredisë para se rënia të identifikohet me një kredi individuale në atë portofol. Kjo evidencë mund të përfshijë të dhëna të vëzhguara që tregojnë se kanë ndodhur ndryshime të padëshiruara në statusin e pagesave të kredive në një grup, ose kushte ekonomike kombëtare apo lokale që lidhen me mospagimin e aktiveve në grup. Drejtimi përdor gjykime bazuar në eksperiencën e humbjes historike për aktivët me karakteristika të rrezikut të kredisë dhe evidencën e zhvlerësimeve të ngjashme me ato të portofolit kur skedulohen flukset e ardhme të parasë. Metodologjia dhe supozimet e përdorura për vlerësimin e shumës dhe kohës së flukseve të ardhme të parasë janë rishikuar në mënyrë të rregullt për të reduktuar çdo diferencë ndërmjet humbjes së vlerësuar dhe humbjes aktuale.

Investimet e mbajtura deri në maturim

Banka ndjek udhëzimet e SNK 39 në klasifikimin e aktiveve financiare jo-derivative me pagesa fikse ose të përcaktuara dhe maturitetet të përcaktuar, si të mbajtura deri në maturitetet. Klasifikimi kërkon gjykime të rëndësishme. Në bërjen e këtij gjykimi, Banka vlerëson qëllimin dhe aftësinë e saj për të mbajtur investime të tilla deri në maturitetet. Nëse Banka dështon të mbajë këto investime deri në maturitetet, përveç rasteve të veçanta, për shembull shitja e një shume jo të konsiderueshme afër maturitetit, do të kërkohej që të klasifikohet e tërë kategoria, si e vlefshme për tu shitur. Investimet do të duhet të maten me vlerën e drejtë dhe jo me koston e amortizuar.

Përcaktimi i vlerës së drejtë

Përcaktimi i vlerës së drejtë për aktivët dhe detyrimet financiare për të cilat nuk ka një çmim tregu të dukshëm kërkon përdorimin e teknikave të vlerësimit siç përshkruhen në politikën kontabël 3(g)(vi). Për instrumentet financiare që tregtohen rrallë dhe që nuk kanë transparencë në çmim, vlera e drejtë është më pak objektive dhe kërkon shkallë të ndryshme gjykimi bazuar në likuiditetin, përqendrimin, pasigurinë e faktorëve të tregut, supozime rreth çmimit dhe rreziqe të tjera që ndikojnë mbi instrumentin specifik. Referoju gjithashtu "Vlerësimi i instrumenteve financiarë " më poshtë.

Gjykimet kritike kontabël në zbatimin e politikave kontabël të Bankës

Gjykime kritike kontabël në zbatimin e politikave kontabël të Bankës përfshijnë:

Vlerësimi i instrumenteve financiarë

Politika kontabël e Bankës për matjen e vlerës së tregut është trajtuar në shënimin 3(g)(vi).

Banka e mat vlerën e drejtë duke përdorur hierarkinë e mëposhtme të metodave:

- Niveli 1: Çmime të kuotuar në një treg aktiv për një instrument identik.
- Niveli 2: Teknika vlerësimi bazuar në inpute të vëzhgueshme. Kjo kategori përfshin instrumente të vlerësuarat duke përdorur çmime të kuotuar në tregje aktive për instrumente të ngjashëm, çmime të kuotuar për instrumente të ngjashëm në tregje që konsiderohen më pak se aktivë; ose teknika të tjera vlerësimi ku të gjithë inputet e rëndësishme janë të vëzhgueshme në mënyrë direkte ose jo-direkte nga të dhënat e tregut.

Banka Kombëtare Tregtare Sh.a.

Shënime mbi Pasqyrat Financiare të Konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013
(shprehur në USD, nëse nuk është shënuar ndryshe)

4. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve (vazhdim)

Vlerësimi i instrumenteve financiarë (vazhdim)

- Niveli 3: Teknika vlerësimi që përdorin inpute të rëndësishme të pavëzhgueshme. Kjo kategori përfshin të gjithë ato instrumente ku teknika e vlerësimit përfshin inpute që nuk bazohen në të dhëna të vëzhgueshme dhe inputet e pavëzhgueshme mund të kenë një efekt të rëndësishëm në vlerësimin e instrumentit. Kjo kategori përfshin instrumente që janë vlerësuar bazuar në çmime të kuotuar për instrumente të ngjashëm ku kërkohen rregullime apo gjykime të rëndësishme e të pavëzhgueshme për të reflektuar ndryshimin midis instrumenteve.

Vlera e drejtë për aktivet dhe detyrimet financiare që tregtohen në tregje aktivë bazohen në çmime tregu të kuotuar apo kuotime te agentëve. Për të gjitha instrumentet e tjerë financiarë Banka përcakton vlerën e drejtë duke përdorur teknika vlerësimi. Teknikat e vlerësimit përfshijnë vlerën aktuale neto dhe modele të skontimit të flukseve monetare, krahasime me instrumente të ngjashëm për të cilët ekzistojnë çmime të dukshme tregu dhe modele të tjera vlerësimi. Objektivi i teknikave të vlerësimit është të arrijnë në përcaktimin e vlerës së drejtë që reflekton çmimin e instrumentit financiar në datën e raportimit, i cili do të ishte përcaktuar nga pjesëmarrës në treg që veprojnë me kushtet e tregut.

Banka përdor modele vlerësimi të njohura gjerësisht për përcaktimin e vlerës së drejtë të instrumenteve financiarë më të thjeshtë dhe më të zakonshëm, si norma interesi dhe këmbime monedhash që përdorin vetëm të dhëna tregu të vëzhgueshme dhe kërkojnë pak gjykim apo vlerësim nga drejtuesit. Çmimet dhe inputet model të vëzhgueshme janë zakonisht të vlefshme në treg për instrumente kapitale dhe huaje të listuara në bursa, derivativë të tregtueshëm me këmbim, dhe derivativë të thjeshtë të tregtueshëm mbi banak si Swaps mbi normat e interesit. Disponueshmëria e çmimeve të vëzhgueshme të tregut dhe e inputeve model redukton nevojën për gjykimin dhe vlerësimin e drejtuesve dhe redukton gjithashtu pasiguritë që shoqërojnë përcaktimin e vlerës së drejtë. Disponueshmëria e çmimeve të vëzhgueshme të tregut dhe inputeve varion në varësi të produkteve dhe tregjeve dhe është e prirur ndaj ndryshimeve bazuar në ngjarjet specifike dhe kushtet e përgjithshme në tregjet financiare.

Për instrumente financiare më komplekse, Banka përdor modele vlerësimi të veçanta, të cilat janë zakonisht të zhvilluara bazuar në modele të njohura vlerësimi. Disa ose të gjithë inputet e rëndësishme në këto modele mund të mos jenë të vëzhgueshme në treg dhe janë rrjedhojë e çmimeve të tregut ose kurseve ose janë vlerësuar bazuar në gjykime. Modelet e vlerësimit që përmbajnë inpute të rëndësishme të pavëzhgueshme kërkojnë një shkallë më të lartë gjykimi dhe vlerësimi nga drejtuesit në përcaktimin e vlerës së drejtë. Gjykimi dhe vlerësimi i drejtuesve kërkohet zakonisht për zgjedhjen e modelit të vlerësimit për t'u përdorur, përcaktimin e flukseve monetare të pritshme për instrumentin financiar që vlerësohet, përcaktimin e probabilitetit për mospagesën apo parapagimet nga pala tjetër dhe përzgjedhjen e normave të përshtatshme për skontim.

Banka Kombëtare Tregtare Sh.a.

Shënime mbi Pasqyrat Financiare të Konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013
(shprehur në USD, nëse nuk është shënuar ndryshe)

4. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve (vazhdim)

Vlera e Drejtë

Tabela më poshtë paraqet vlerën kontabël dhe vlerën e drejtë të aktiveve dhe detyrimeve financiare, të matura me vlerën e drejtë në fund të periudhës raportuese, sipas nivelit të hierarkisë së vlerës së drejtë, në të cilën është kategorizuar matja e vlerës së drejtë:

31 dhjetor 2013	Shënime	Vlera kontabël		Vlera e Tregut			
				Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	Totali
Depozita dhe llogari me bankat	8	201,279,874	-	201,279,874	-	201,279,874	
Bono thesari	9	236,724,368	-	236,724,368	-	236,724,368	
Investime të vlefshme për shitje	10	697,179,575	194,903,826	423,269,186	79,006,563	697,179,575	
Investime të mbajtura deri në maturim	11	217,755,420	49,736,912	168,512,656	-	218,249,568	
Hua dhe paradhënie për bankat	12	121,650,866	-	121,650,866	-	121,650,866	
Hua dhe paradhënie për klientët, neto	13	886,202,417	-	886,202,417	-	886,202,417	
Totali i aktiveve financiare		2,360,792,520	244,640,738	2,037,639,367	79,006,563	2,361,286,668	
Detyrime ndaj klientëve	18	2,154,265,396	-	2,154,265,396	-	2,154,265,396	
Detyrime ndaj bankave e institucioneve financiare	19	278,355,823	-	278,355,823	-	278,355,823	
Borxhi i varur	23	13,796,864	-	13,796,864	-	13,796,864	
Totali i detyrimeve financiare		2,446,418,083	-	2,446,418,083	-	2,446,418,083	
31 dhjetor 2012	Shënime	Vlera kontabël		Vlera e Tregut			
				Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	Totali
Depozita dhe llogari me bankat	8	149,439,990	-	149,439,990	-	149,439,990	
Bono thesari	9	266,464,865	-	266,478,358	-	266,478,358	
Investime të vlefshme për shitje	10	369,864,054	108,570,735	233,406,738	27,886,581	369,864,054	
Investime të mbajtura deri në maturim	11	221,912,787	34,043,243	188,519,250	-	222,562,493	
Hua dhe paradhënie për bankat	12	192,135,941	-	192,135,941	-	192,135,941	
Hua dhe paradhënie për klientët	13	854,185,956	-	854,185,956	-	854,185,956	
Totali i aktiveve financiare		2,054,003,593	142,613,978	1,884,166,233	27,886,581	2,054,666,792	
Detyrime ndaj klientëve	18	1,884,887,955	-	1,884,887,955	-	1,884,887,955	
Detyrime ndaj bankave e institucioneve financiare	19	239,104,842	-	239,104,842	-	239,104,842	
Borxhi i varur	23	13,195,323	-	13,195,323	-	13,195,323	
Totali i detyrimeve financiare		2,137,188,120	-	2,137,188,120	-	2,137,188,120	

Vlera e tregut e kontratave të kursit të këmbimit i afrohet vlerës kontabël të tyre, siç paraqitet në shënimet 17 dhe 22.

Banka Kombëtare Tregtare Sh.a.

Shënime mbi Pasqyrat Financiare të Konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013
(shprehur në USD, nëse nuk është shënuar ndryshe)

5. Administrimi i rrezikut financiar

(a) Hyrje e përgjithshme

Banka është e ekspozuar ndaj rreziqeve të mëposhtme nga përdorimi i instrumenteve financiare:

- rreziku i kredisë
- rreziku i likuiditetit
- rreziqet e tregut
- rreziku operacional

Ky shënim paraqet informacion rreth ekspozimit të Bankës ndaj secilit prej rreziqeve të mësipërme, objektivat, politikat dhe proceset e Bankës për matjen dhe administrimin e rrezikut, dhe administrimin e kapitalit të Bankës.

Një instrument financiar është çdo kontratë që jep mundësinë për të marrë mjete monetare ose aktive të tjera financiare nga një palë tjetër (aktiv financiar) ose detyrimin për të dhënë mjete monetare ose ndonjë aktiv tjetër financiar ndonjë pale tjetër (detyrim financiar).

Instrumentet financiare rezultojnë me rrezik për Bankën. Rreziqet kryesore me të cilët përballet Banka janë rreziku i kredisë, rreziku i likuiditetit dhe ai i tregut. Rreziku i tregut përfshin rrezikun në monedhë të huaj, rrezikun e normës së interesit dhe rreziqe të tjera çmimi.

Struktura e administrimit të rrezikut

